



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE

Fakulteti i Drejtësisë

STUDIMET POSTDIPLOMIKE-MASTER

DREJTIMI PENAL

PUNIM MASTERI

DELIKUENCA E TË MITURVE NË TERRITORIN

E GJYKATËS THEMELORE FERIZAJ

PËR PERIUDHËN KOHORE 2014-2019

Kandidati:

Shpëtim Vishi

Mentori:

Prof. Dr. Ismail Zejneli

Tetovë, 2020

Përmbajtja.....	2
HYRJE.....	5
1. Objekti dhe interesi shkencor i studimit.....	5
2. Metodologjia e studimit.....	6
3. Struktura e punimit.....	7

KAPITULLI I

VËSHTRIME TË PËRGJITHSHME LIDHUR ME DELIKUENCËN E TË MITURVE.....	9
1. Nocioni, karakteristikat dhe historiku i delikuencës së të miturve.....	9
2. Pozita e kryerësve të mitur sipas Legjislacionit Penal të Kosovës dhe akteve ndërkombëtare.....	12
2.1. Kodi i Drejtësisë për të Mitur.....	14
2.2. Deklarata për të drejtat e fëmijëve e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së.....	16
2.3. Rregullat e Pekinit.....	17
2.4. Konventa ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve.....	17
3. Trajtimi i kriminalitetit të të miturve sipas të drejtës zakonore shqiptare.....	18
4. Trajtimi i kriminalitetit të të miturve sipas Ligjit mbi Drejtësinë për të Mitur të Republikës së Maqedonisë së Veriut.....	18
5. Trajtimi i kriminalitetit të të miturve sipas Kodit mbi Drejtësinë për të Mitur të Republikës së Shqipërisë.....	21

KAPITULLI II

LLOJET E MASAVE DHE DËNIMEVE TË CILAT MUND T’U SHQIPTOHEN TË MITURVE SIPAS KODIT TË DREJTËSISË PËR TË MITUR TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS.....	24
1. Llojet e masave dhe dënimeve.....	24
2. Masat e diversitetit ndaj të miturve sipas sistemit tonë penal.....	25
3. Konsiderime të përgjithshme për rolin e zyrtarit sprovues dhe zbatimin e secilës masë të diversitetit.....	27

4. Masat edukative.....	31
5. Gjyba dhe urdhëri për punë në dobi të përgjithshme.....	34
6. Burgimi për të mitur.....	36
7. Masat e trajtimit të detyrueshëm dhe dënimet plotësuese.....	37

KAPITULLI III

FAKTORËT E PARAQITJES TË DELIKUENCËS SË TË MITURVE.....	40
1. Vështrime të përgjithshme lidhur me faktorët e paraqitjes së delikuencës së të miturve..	40
2. Faktorët individualë të paraqitjes së delikuencës së të miturve.....	41
3. Faktorët ekonomiko-socialë.....	48
4. Ndikimi i mjeteve të komunikimit masiv dhe delikuenca e të miturve.....	50
5. Modelet e suksesshme të parandalimit të kriminalitetit të të miturve.....	54
6. Shërbimi Sprovues në Kosovë dhe roli i tij në zbutjen e dukurisë së të miturve.....	56
7. Shërbimi Korrektues në Kosovë dhe roli i tij në zbutjen e dukurisë së delikuencës së të miturve.....	59

KAPITULLI IV

DELIKUENCA E TË MITURVE NË GJYKATËN THEMELORE NË FERIZAJ GJATË PERIUdhËS KOHORE 2014-2019.....	60
1. Numri i rasteve të delikuencës së të miturve në Gjykatën Themelore në Ferizaj për periudhën kohore 2014-2019.....	60
2. Dinamika e delikuencës së të miturve në Gjykatën Themelore në Ferizaj për periudhën kohore 2014-2019.....	61
3. Llojet e masave dhe dënimeve të shqiptuara ndaj të miturve në Gjykatën Themelore në Ferizaj për periudhën kohore 2014-2019.....	62
4. Llojet e veprave penale të kryera nga të miturit në regjionin e Ferizajt për periudhën kohore 2014-2019.....	63
5. Disa karakteristika personale dhe sociale të delikuentëve të mitur në regjionin e Ferizajt për periudhën kohore 2014-2019.....	64

5.1. Moshë.....	65
5.2. Gjina	66
5.3. Niveli arsimor.....	67
5.4. Profesioni.....	68
5.5. Statusi social.....	69
5.6. Statusi martesor.....	70
5.7. Përkatësia kombëtare.....	71
 Përfundimi.....	 73
Literatura.....	77

HYRJE

1. Objekti dhe interesi shkencor i studimit

Shtytës për hartimin e këtij punimi të masterit ka qenë dhe mbetet rëndësia jashtëzakonisht e madhe e kësaj teme, dëshira ime e veçantë për të ndikuar në forcimin e bindjes institucionale dhe të respektimit të ligjit në teori e në praktikë. Por, edhe qëllimi final për të dhënë një kontribut plus për ngritjen e standarteve ligjore të aplikuara në vendin tonë sa i përket delikuencës së të miturve.

Delikuenca e të miturve si formë e paraqitjes në kriminalitetin e përgjithshëm si në çdo vend tjetër edhe në Kosovë ka një peshë specifike të konsiderueshme, si për nga format e shfaqjes ashtu edhe për nga llojllojshmëria e veprave të kryera, pasojat e dëmshme njerëzore, sociale, ekonomike, psikologjike e të tjera për shëndetin, mirëqenien dhe pasurinë e individit, të familjes dhe shoqërisë në përgjithësi. Në këtë punim delikuenca e të miturve është shqyrtuar dhe trajtuar në aspektin fenomenologjik të paraqitjes së saj, pastaj janë studiuar edhe faktorët etiologjik të paraqitjes së delikuencës së të miturve dhe gjithashtu është paraqitur edhe roli i masave preventive dhe masave represive të shqiptuara gjatë periudhes hulumtuese. Këto këndvështrime të ndryshme janë elaboruar në aspektin social, ekonomik, psikologjik, pedagogjik, sociologjik, juridiko-penal etj.

Një studim i tillë është i nevojshëm për njohjen e kësaj dukurie dhe për luftimin më të efektshëm të delikuencës së të miturve. Zgjedhja e temës është mbështetur në nevojën e njohjes sa më të mirë të aspekteve të luftimit më të suksesshëm të kësaj dukurie, duke i njohur format, vëllimin, dinamikën, shkaqet, organet e autorizuar për trajtimin e kësaj dukurie të dëmshme shoqërore etj. Çdo shoqëri, në pajtim me parametrat e mundshëm, është e interesuar për edukimin e gjeneratave të reja si bartëse të ardhshme të ekzistencës së shoqërisë njerëzore. Për të arritur një edukim cilësor, shoqëria njerëzore duhet t'i kushtojë kujdes të posaçëm disa dukurive

asociale të rinjve. Si dukuri e veçantë asociale është shkelja e normave ligjore në fuqi nga ana e të miturve që përbëjnë delikuencën e të miturve.

Delikuenca e të miturve është hulumtuar pak në Kosovë e këtë e shohim nga pasqyra e raporteve të organizatave qeveritare dhe joqeveritare për mungesën e vëmendjes së institucioneve relevante për këtë dukuri, prandaj si qëllim i hulumtimit të kësaj teme qëndron zgjerimi dhe thellimi i njohurive rreth faktorëve të jashtëm dhe të brendshëm, njohja e motiveve që dërgojnë në paraqitjen e kësaj dukurie.

Në kuadër të masave të ndryshme dominojnë masat preventive edukuese dhe pedagogjike, të cilat konsistojnë në zhvillimin pozitiv të të miturve, në zgjidhjen e problemeve familjare dhe shoqërore, në aftësimin profesional të tyre dhe në sigurimin e perspektivës. Mirëpo çdo shoqëri është shtrënguar të përdorë edhe masa dhe sanksione penale, të cilat dallojnë nga përmbajtja e sanksioneve penale për të rritur. Pra trajtimi i të miturve është më i favorshëm në fushën e legjislacionit penal, material dhe procedural.

2. Metodologjia e studimit

Për realizimin dhe finalizimin e këtij studimi janë zbatuar metodat bazë të studimeve empirike. Për interpretimin e rezultateve kërkimore dhe gjetjeve janë përdorur gjerësisht: metoda e analizës së të dhënave dhe fakteve, e sintezës, metoda e kërkimit doktrinar, metoda statistikore, metoda e referimit tek instrumentet ligjore etj.

Kërkimi doktrinar përbën një tjetër hap në realizimin e këtij punimi, nëpërmjet të të cilit është arritur identifikimi, mbledhja dhe sistemimi i librave, monografive, studime shkencore të autorëve dhe bashkautorëve specialistë të fushës së të drejtës penale për të mitur.

Një metodë tjetër që ndjek hartimin e këtij punimi është metoda e analizës së legjislacionit. Për të arritur realizimin sa më të plotë të objektivave që synohen të përmbushen në këtë punim, jemi mbështetur në metodën e analizës dhe sintezës, metodë kjo e cila konsiston në formulimin e problemeve ligjore nëpërmjet analizës së normativës që shqyrtohet.

Me metodën statistikore kemi arritur t'i grumbullojmë të dhënat, t'i analizojmë dhe t'i krahasojmë si edhe selektimin e të dhënave për delikuencën e të miturve në regjionin e Ferizajt për periudhën kohore 2014-2019.

Me metodën krahasuese kanë dalë në pah risitë dhe përparësitë e objektit të studimit, si dhe përfundimet e bazuara në argumente bindëse e po ashtu edhe problematika në lidhje me objektin e studimit.

Me metodën normative është hulumtuar ana formale e normave dhe akteve juridike, duke u bazuar kryerësisht në fuqinë e tyre juridike e duke studiuar përbërjen e ligjeve dhe rregulloreve, si dhe lidhjet dhe raportet ndërmjet tyre.

Ndërkaq, përmes metodës interpretuese është realizuar gërshetimi i metodave të mësipërme, duke arritur në konkluzione mbi atë se çfarë mund të përmirësohet nga pikëpamja legislative, por edhe zbatimi në praktikë i legjislacionit ekzistues.

3. Struktura e punimit

Ky punim i masterit përmban pjesën hyrëse, katër kapituj, përfundimin dhe literaturën. Punimi nis me vështrime të përgjithshme lidhur me delikuencën e të miturve duke shtjelluar nocionin, karakteristikat dhe historikun e delikuencës së të miturve, pozitën e kryerësve të mitur sipas legjislacionit penal të Kosovës dhe akteve ndërkombëtare, Kodin e Drejtësisë për të Mitur, Deklaratën për të drejtat e fëmijëve, të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, Rregullat e Pekinit, Konventën ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve, trajtimin e kriminalitetit të të miturve sipas të drejtës zakonore shqiptare, trajtimin e kriminalitetit të të miturve sipas Ligjit mbi Drejtësinë për të Mitur të Republikës së Maqedonisë së Veriut, trajtimin e kriminalitetit të të miturve sipas Kodit të Drejtësisë për të Mitur të Republikës së Shqipërisë.

Në kapitullin e dytë kam shtjelluar llojet e masave dhe dënimeve të cilat mund t'u shqiptohen të miturve sipas KDM-së të Republikës së Kosovës, si: llojet e masave dhe dënimeve, masat e diversitetit ndaj të miturve sipas sistemit tonë penal, konsiderime të përgjithshme për rolin e zyrtarit sprovues dhe zbatimin e secilës masë të diversitetit, masat edukative, gjobat dhe urdhërat për punë në dobi të përgjithshme, burgimin e të miturve dhe masat e trajtimit të detyrueshëm dhe dënimet plotësuese.

Në kapitullin e tretë kam paraqitur faktorët e paraqitjes së delikuencës së të miturve, si: vështrime të përgjithshme lidhur me faktorët e paraqitjes së delikuencës së të miturve, faktorët individualë të paraqitjes së delikuencës së të miturve, faktorët ekonomiko-socialë, ndikimi i

mjeteve të komunikimit masiv dhe delikuenca e të miturve, modelet e suksesshme të parandalimit të kriminalitetit të të miturve, Shërbimi Sprovues në Kosovë dhe roli i tij në zbutjen e dukurisë së delikuencës së të miturve dhe Shërbimi Korrektues në Kosovë dhe roli i tij në zbutjen e dukurisë së delikuencës së të miturve.

Në kapitullin e fundit kam paraqitur delikuencën e të miturve në Gjykatën Themelore në Ferizaj gjatë periudhës kohore 2014-2019, si: numri i rasteve të delikuencës së të miturve në Gjykatën Themelore në Ferizaj për periudhën kohore 2014-2019, dinamika e delikuencës së të miturve në Gjykatën Themelore në Ferizaj për periudhën kohore 2014-2019, llojet e masave dhe dënimeve të shqiptuara ndaj të miturve në Gjykatën Themelore në Ferizaj për periudhën kohore 2014-2019, llojet e veprave penale të kryera nga të miturit në regionin e Ferizajt për periudhën kohore 2014-2019 dhe disa karakteristika personale dhe sociale të delikuentëve të mitur në regionin e Ferizajt për periudhën kohore 2014-2019, si mosha, gjina, niveli arsimor, profesioni, statusi social, statusi martesor dhe përkatësia kombëtare.

KAPITULLI I

VËSHTRIME TË PËRGJITHSHME LIDHUR ME DELIKUENCËN E TË MITURVE

1. Nocioni, karakteristikat dhe historiku i delikuencës së të miturve

Me kriminalitet të të miturve kuptojmë tërësinë e sjelljeve kriminale të kryera nga persona që kanë mbushur moshën 14 vjeç dhe nuk janë më të vjetër se 18 vjet.¹ Delikuenca e të miturve i përfshin të gjitha aktivitetet e të miturve që janë të inkriminuar sipas ligjeve pozitive penale të disa shteteve.²

Sanksionet penale ndaj të miturve janë masa të reagimit shoqëror të cilat mund të shqiptohen ndaj kryerësve të mitur të veprave penale. Ato manifestojnë disa veçori dalluese në krahasim me sanksionet penale që mund t'u shqiptohen kryerësve madhorë të veprave penale, nga fakti se të miturit dallohen nga kryerësit madhorë jo aq tepër për nga llojet e veprave penale dhe të sjelljeve të tjera delikuede, por për më tepër për nga mosha dhe vetitë e tyre të natyrës psikike, psiko-fizike, sociale, biologjike etj.³

Me delikuencën e të miturve nënkuptojmë tërësinë e të gjitha krimeve të kryera në kohë, hapsirë dhe periudhë të caktuar nga personat e mitur. Kriminaliteti është dukuri masovike e në vete përmbledhë të gjitha format e krimeve, të cilat kryhen në një vend.⁴ Krimi është veprim konkret dhe manifestohet në cenimin dhe rrezikimin e ndonjë të mire të mbrojtur me norma pozitive të një shteti. Krimi ka për pasojë dënimin. Krimi mund të jetë i rëndë dhe i lehtë varësisht nga cenimi, rrezikimi, apo motivet nga të cilat është kryer ai.⁵

Ndërsa në përkufizimet e Kodit të Drejtësisë për të Mitur përkufizon termit: Termi “fëmijë” do të thotë personi që nuk e ka mbushur moshën 18 vjeçare, termi “I mitur” do të thotë personi

¹ Ismil Zejneli, Delikuenca e të miturve, Tetovë, Prishtinë, 2018, fq. 19.

² Po aty, fq. 20.

³ Rexhep Gashi, “Politika ndëshkimore ndaj delikteve të gjakut në Kosovë gjatë periudhës 1980-1989”, Prishtinë 2003, fq. 139.

⁴ Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2007, fq. 21.

⁵ Po aty.

ndërmjet moshës 14 dhe 18 vjeçare,⁶ ndërsa kryerës i krimit konsiderohet personi i cili ka kryer krimin, respektivisht personi që e kryen veprën penale⁷ quhet subjekt i veprës penale⁸ dhe vepra penale është veprimi ose mosveprimi, me të cilin cenohet apo rrezikohet një e mirë e mbrojtur me ligj penal, apo dispozitë tjetër penale pozitive.⁹

Karakteristikë e përbashkët e kriminalitetit të të miturve është ajo se kemi të bëjmë me persona të mitur të cilët janë dhënë pas sjelljeve kriminale. Kriminaliteti i të miturve manifestohet në forma të ndryshme dhe paraqet rrezik përmanent për shoqërinë bashkëkohore në përgjithësi e po ashtu, si karakteristikë e përbashkët të cilën e hasim në të gjitha legjislacionet penale është se personat e mitur nuk janë të pjekur si duhet mentalisht, nuk kanë edhe aftësitë e të mendurit si edhe personat e rritur dhe për këtë shkak duhet të aplikohen masa preventive dhe riedukuese. Si karakteristikë tjetër e përbashkët paraqitet edhe limiti i moshës së personave të mitur, sepse varësisht nga mosha shtrohet edhe çështja e përgjegjësisë penale, pastaj shqiptimi i masave edukuese-përmirësuese, shqiptimi i dënimeve tjera, por edhe trajtimi edukativo-përmirësues nëpër entet edukuese-përmirësuese. Mosha e kryerësit të mitur të veprës penale është karakteristikë e rëndësishme e fenomenit kriminal.¹⁰

Përgjegjësia penale e të miturve, si element subjektiv i veprës penale, është kusht që një vepër të konsiderohet vepër penale, në mënyrë që kryerësit të saj do të mund t'i shqiptohet sanksioni penal adekuat. Një person konsiderohet penalisht përgjegjës nëse në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë i përgjegjshëm dhe i fajshëm.¹¹

Pra, sipas Legjislacionit penal në fuqi në Kosovë, personat e mitur prej 14-18 vjeç konsiderohen si të përgjegjshëm, por këtu mund të vërehet një trajtim juridiko-penal më adekuat ndaj kategorisë së personave prej 14-16 vjeç, të ashtuquajtur të mitur të ri, ndaj të cilëve gjykata mund të shqiptojë vetëm masat edukuese e asesi dënime, pa marrë parasysh se çfarë vepre penale kanë kryer. Ndërsa, ndaj personave të mitur të rritur 16-18 vjeç, përveç masave edukuese, në raste të caktuara me ligj mund t'u shqiptohet edhe dënimi i posaçëm për të mitur-burgu për të

⁶ Kodi Nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur, Tetor 2018, Prishtinë, neni 3 pika 1 dhe 2.

⁷ Vepra penale është vepër e kundërligjshme që me ligj është e caktuar si vepër penale dhe veçoritë e së cilës janë të caktuara me ligj. Për më shumë rreth definicionit të veprës penale shih: Vllado Kambovski, Ismail Zejneli, E drejta penale-pjesa e përgjithshme, Tetovë, 2018, fq. 79.

⁸ Ismet Salihu, E drejta penale, pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2015, fq. 189.

⁹ Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2007, fq. 21.

¹⁰ Po aty.

¹¹ Ismet Salihu, E drejta penale, pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2015, fq. 276.

mitur.¹² Pasojat e kriminalitetit që i shkaktojnë të miturit mund të jenë të natyrave të ndryshme, si njerëzore, ekonomike-sociale, psikologjike, politike etj., gjë që veprat penale të të miturve mund të jenë nga vjedhjet deri ato më të rëndat, vrasjet.¹³

Sa i përket delikuencës së të miturve në periudha të ndryshme historike themi se sjelljet e delikentëve të mitur gjatë historisë kanë qenë të llojllojshme dhe të vjetra sa edhe vetë njerëzimi. Në fillim është trajtuar vetëm përgjegjësia objektive, pra manifestimi i pasojës së dëmshme, në botën e jashtme dhe më vonë ka filluar trajtimi edhe i motivit të brendshëm të kryerësit.¹⁴ Zhvillimi i të drejtës penale në aspektin e përgjegjësisë penale të të miturit dëshmon se shumë herët kanë filluar të bëhen disa ndryshime të caktuara në mes të kryerësve të mitur dhe atyre të rritur, e që kryesisht janë bazuar në momentin intelektual të personalitetit të kryerësit.¹⁵ Në të drejtën romake, personat prej moshës 10 deri në 14 vjeç, janë konsideruar të përgjegjshëm, por janë dënuar shumë më butë.

Përgjegjësia penale e të miturve ka filluar të trajtohet më mirë në fund të shek. XVIII. Ky përmirësim është arritur me Kodin e Francës të vitit 1810. Sipas dispozitave të këtij Kodi, penalisht përgjegjës janë trajtuar personat mbi moshën 16 vjeç, të cilët e kanë kuptuar rëndësinë e veprës së vet, ndërsa ndaj atyre që nuk e kanë kuptuar rëndësinë e veprës së kryer, janë aplikuar masa të posaçme me qëllim të përmirësimit dhe riedukimit të tyre. Gjatë shek. XX, legjislacionet e shteteve të ndryshme kanë paraparë edhe një mesokategori, grupin në mes të moshës së mitur dhe madhore e që këta quhen madhorë të rinj dhe janë të moshës 18 - 21 vjeç. Ndaj kësaj kategorie është paraparë mundësia e shqiptimit të disa masave edukuese, si lloje të posaçme të sanksioneve penale. Me paraqitjen e masave edukuese për herë të parë fillojnë të paraqiten edhe gjykata të posaçme për të mitur. Gjykata e parë për të mitur është themeluar në vitin 1899 në Çikago, ndërsa pas themelimit të saj gjykata për të mitur filluan të formohen edhe në vende të tjera. Tani pothuajse të gjitha shtetet bashkëkohore kanë themeluar gjykata të posaçme për të mitur apo senate (kolegje) të posaçme për të mitur, të cilat merren me gjykimin e kryerësve të mitur të veprave penale.¹⁶

¹² Kodi Nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur, Tetor 2018, Prishtinë, neni 7.

¹³ Azem Hajdari, Kriminaliteti i të miturve 2001-2003, Prishtinë, 2004, fq. 34.

¹⁴ Ismet Salihu, E drejta penale për të mitur, Prishtinë, 2005, fq. 14.

¹⁵ Vesel Latifi, Kriminalistikat e delikuencës së të miturve, Prishtinë, 1982, fq. 35.

¹⁶ Ismet Salihu, E drejta penale për të mitur, Prishtinë, 2005, fq. 35.

Pozita e të miturve është përmirësuar në shek. XVIII-XIX, por avansimi më i madh është arritur me Ligjin Penal Francez, në vitin 1810, i cili pati ndikim në shumë shtete të Evropës, me ç'rast janë përgjegjës personat mbi moshën 16 vjeç, të cilët e kanë kuptuar rëndësinë e veprës penale, ndërsa ndaj atyre që nuk e kanë kuptuar peshën e veprës penale janë aplikuar masa të posaçme penalo-juridike më qëllim përmirësimi dhe riedukimi. Pas gjysmës së dytë të shek. XX, një numër i madh i shteteve në legjislacionet e tyre kanë paraparë edhe një kategori të mesme personash, në mes të miturve dhe personave madhorë. Këta quhen madhorë të rinj (18-21 vjeç). Ndaj tyre, në disa raste të caktuara me ligj është paraparë edhe mundësia e shqiptimit të disa masave edukuese.¹⁷ Në Greqinë antike sjelljet e të miturve konsideroheshin si dëme të shkatuara dhe dënimi është bërë vetëm për të kënaqur dëshirat e palës së dëmtuar. Ligji i XII tabelave parashihte dënimin për të mitur në tabelën IX, e kjo është shqiptuar kur është zënë në kryerjen e veprës penale të vjedhjes.¹⁸

2. Pozita e kryerësve të mitur sipas legjislacionit penal të Kosovës dhe akteve juridike ndërkombëtare

Delikueca e të miturve në vendin tonë gjatë periudhave të ndryshme historike, si dukuri negative, i ka karakteristikat e njëjta, por megjithatë ka edhe veçoritë e veta. Sipas burimeve historike, që nga kohët ilire, ka ekzistuar një trajtim i veçantë ndaj kryerësve të mitur, si nga ana e prindërve apo familjes e po ashtu edhe nga ana e shoqërisë. Trajtimi i të miturve në këtë kohë nuk është bazuar në rregullimin ligjor të kësaj fushe, por në traditën zakonore. Fëmijët gjer në moshën shtatë vjeç nuk kanë qenë penalisht të përgjegjshëm, kurse pas kësaj moshe kryerësit janë përgjigjur vetë ose prindërit e tyre. Ndërsa trajtimi i kryerësve të mitur të veprave penale në kohën e Perandorisë Osmane ka qenë i ndryshëm për shkak se ndaj të miturve janë aplikuar ligjet e Perandorisë Osmane dhe gjithashtu janë zbatuar edhe normat që ka përmbajtur e drejta zakonore shqiptare, përkatësisht Kanuni i Lekë Dukagjinit, edhe pse në rregullat që përmaban trajtohet shumë pak çështja e të miturve.¹⁹

¹⁷ Ismet Salihu, E drejta penale për të mitur, Prishtinë, 2005, fq. 16

¹⁸ Po aty.

¹⁹ Po aty, fq. 17.

Mirëpo, sipas të drejtës zakonore shqiptare penalisht përgjegjës ka qenë i riu i cili ka mund ta përdorë armën, ku përafërsisht është mosha 17 vjeç. Ndërsa përgjegjës për veprimet e të miturve deri në këtë moshë ka qenë kryefamiljari ose prindi mashkull. Masat edukuese për të mitur e drejta jonë zakonore nuk i ka paraparë. Në Ligjin Penal të ish-Jugosllavisë të vitit 1974, personat gjerë në moshën 14 vjeç nuk konsideroheshin penalisht të përgjegjshëm për veprën e kryer. Ndërsa të përgjegjshëm trajtoheshin nga mosha 14 vjeç deri në moshën 18 vjeç, përkatësisht deri në moshën 20 vjeç dhe trajtoheshin si kryerës të mitur të veprave penale.²⁰

Në vitin 1974 miratohet Kushtetuta e Kosovës dhe më vonë miratohet edhe Ligji Penal i Kosovës i vitit 1977. Sipas dispozitave të këtij Ligji, të miturit kategorizoheshin në dy grupe: grupi i parë që përfshinë të miturit e moshës 14-16 vjeç dhe grupi i dytë me të miturit e moshës 17-18 vjeç, përkatësisht 20 vjeç. Mirëpo Ligji penal i RSFJ-së parashikonte disa kufizime për shkak të të cilave nuk mund të zbatoheshin disa dispozita të këtij ligji edhe pse ishte më i avancuar në trajtimin e të miturve. Gjatë zhvillimit historik ndaj të miturve janë aplikuar dispozita të ndryshme, ku të miturit në raste të shumta janë trajtuar jo drejt dhe nuk bënë dallimin në moshë në mes të miturve dhe të rriturve. Këtij trajtimi joadekuat i janë nënshtruar sidomos të miturit në ish-Jugosllavi për shkak të marrjes pjesë në procese politike e veçanërisht në demonstratat e viteve 1981-1989, ku të miturit dënoheshin në bazë të dispozitave ligjore për të rritur.²¹

Që nga suprimimi i autonomisë së vendit tonë në vitin 1989 nga ana e Sërbisë e deri në çlimirin e vendit tonë, në Kosovë janë zbatuar ligjet serbe dhe zbatimi i këtyre ligjeve për shqiptarët, si edhe për të miturit e kombit tonë ka qenë diskriminues. Ndërsa që nga paslufta janë bërë përpjekje për trajtimin më adekuat të delikuencës së të miturve në aspektin legjislativ, duke nxjerrë në vitin 2004 Ligjin Penal për të Mitur, me të cilin janë paraparë zgjidhje në përputhje me standardet më të larta evropiane dhe botërore. Legjislacioni i aplikuar në Kosovë, në disa raste ka lënë mundësinë e zbatimit edhe të së drejtës ndërkombëtare. Me këtë na jep të kuptojmë se në Kosovë përpos që zbatohen burime të brendshme juridike penale, për të miturit zbatohet edhe e drejta ndërkombëtare.²² Ndërsa si burim themelor i së drejtës pozitive është Kodi i Drejtësisë për të Mitur, i cili rregullon procedurën penale ndaj të miturve, pastaj Kodi i

²⁰ Ismet Salihu, E drejta penale për të mitur, Prishtinë, 2005, fq. 17.

²¹ Po aty, fq. 18.

²² Po aty, fq. 19.

Procedurës Penale të Kosovës, i cili ofron parimet themelore procedurale në bazë të të cilave është hartuar Kodi i Drejtësisë për të Mitur.

2.1. Kodi i Drejtësisë për të Mitur

Kodi i Drejtësisë për të Mitur paraqet një model të shteteve të zhvilluara të Evropës Perëndimore, Francës, Italisë, Zvicës, e që kjo vërëhet me paraqitjen e risive, si: shqiptimi i masave të diversitetit dhe masave edukuese, si masa jopenale ndaj kryerësve të mitur, pastaj I masave alternative që paraqesin prioritet në krahasim me dënimet, ndërsa sa i përket masave të sipërtheksuara rol të rëndësishëm do të ketë shërbimi sprovues, së bashku me organin e kujdestarisë, në bashkëpunim me prindërit e kryerësve të mitur të veprave penale, prokurorinë, policinë dhe gjykatën.

Kurse dënimi me burgim i të miturve, si sanksion i fundit që mund të shqiptohet ndaj tyre, rekomandohet që mundësisht të jetë në kohëzgjatje sa më të shkurtër, sanksion i cili është hartuar në bazë të dispozitave të rregullave të Pekinit, të njohura si rregullat minimale për dhënien e drejtësisë për të mitur, lidhur me masat dhe sanksionet alternative, Konventa e të drejtave të fëmijëve, më 20.11.1989, Deklarata për të drejtat e fëmijëve e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, më 20.11.1959, akte ndërkombëtare të cilat janë miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara.²³

Kodi i Drejtësisë për të Mitur i kushton rëndësi të posaçme trajtimit juridiko-penal të të miturve dhe shpreh një humanizëm ndaj personalitetit të tyre, duke marrë parasysh nevojat personale dhe moshën e tyre. KDM ka paraparë se kur ndaj të miturit shqiptohet ndonjë masë apo dënim gjykata në radhë të parë merr parasysh interesin më të mirë të të miturit. Gjykata gjithashtu merr parasysh edhe këto rrethana: llojin dhe peshën e veprës penale, moshën e të miturit, nivelin e zhvillimit psikologjik, karakterin e tij dhe prirjet, motivet për kryerjen e veprës penale, edukimin e tij në atë fazë, mjedisin dhe rrethanat e jetës së tij, nëse është shqiptuar masë apo dënim më herët dhe rrethanat tjera që mund të ndikojnë në shqiptimin e masës apo dënimit.²⁴

²³ Ismet Salihu, E drejta penale për të mitur, Prishtinë, 2005, fq. 21.

²⁴ Kodi Nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur, Tetor 2018, Prishtinë, neni 7, parag. 1.

Parimet themelore

- Interesi më i mirë duhet të jetë konsiderata mbizotëruese gjatë gjithë procedurës dhe veprimeve që ndërmerren ndaj fëmijës dhe të miturit.
- Sistemi i drejtësisë për të mitur synon mirëqenien e të miturit dhe siguron që çdo reagim ndaj kryerësve të mitur të jetë gjithmonë në proporcion me rrethanat e kryerësit dhe veprës penale.
- Kryerësve të mitur u shqiptohen masat e diversitetit dhe masat edukative, sipas nevojës, duke i dhënë përparësi masave dhe sanksioneve alternative në relacion me sanksionet penale.
- Privimi nga liria shqiptohet vetëm si mjet i fundit dhe do të kufizohet në afatin më të shkurtër të mundshëm. Gjatë kohës së privimit nga liria, shqiptuar si dënim, kryerësit të mitur i ofrohet edukim, ndihmë psikologjike, sipas nevojës, edhe ndihmë mjekësore, për ta lehtësuar rehabilitimin e tij.
- Fëmijës që i nënshtrohet procedurës penale i ofrohet mundësia të shprehet lirisht.
- Çdo i mitur i privuar lirie trajtohet me humanizëm për hir të dinjitetit të personalitetit të tij njerëzor dhe me atë rast merren parasysh nevojat personale të moshës së tij. Në veçanti, çdo i mitur i privuar lirie ndahet nga madhorët, përpos nëse konsiderohet se është në interes të të miturit të mos ndahet, dhe gëzon të drejtën e mbajtjes së kontakteve me familjen e tij përmes korrespondencave dhe vizitave, përveç rrethanave të jashtëzakonshme të përcaktuara me ligj.
- Çdo i mitur i privuar lirie ka të drejtë ndihme të menjëhershme ligjore dhe ndihme tjetër adekuate, si dhe të drejtën për të kundërshtuar ligjshmërinë e privimit të tij nga liria pranë një gjykate të pavarur dhe të paanshme, si dhe në procedurë të menjëhershme.
- Për t'iu shmangur lëndimit për shkak të publicitetit të tepruar ose etiketimeve, e drejta e fëmijës për privatësi respektohet në të gjitha fazat. Në parim, nuk publikohet asnjë informacion që shpie në identifikimin e kryerësit të mitur apo riviktimizimin e viktimës.
- Procedura ndaj të miturit dhe procedra në të cilën i mituri është i dëmtuar me vepër penale është urgjente. Organet të cilat marrin pjesë në procedurë ndaj të miturit si dhe organet tjera dhe institucionet nga të cilat kërkohen njoftime, raporte ose mendime, janë të detyruar të veprojnë në mënyrë urgjente.

- Mosveprimi sipas procedurës së përcaktuar më lartë, si dhe mosrespektimi i afateve të parapara me këtë kod, mund të konsiderohet shkelje disiplinore, në pajtim me dispozitat përkatëse të legjislacionit në fuqi.
- Procedura ndaj fëmijëve dhe të miturve duhet të zhvillohet dhe zbatohet në pajtim me konceptin e qasjes miqësore.²⁵

Për fëmijën nën moshën katërmëdhjetë (14) vjeç nuk fillon procedura gjyqësore. Nëse fëmija është nën moshën katërmëdhjetë (14) vjeç në kohën e kryerjes së veprës penale, çdo procedurë gjyqësore që ka filluar pushohet menjëherë dhe organi i kujdestarisë njoftohet për rastin nga policia pas konsultimit me prokurorin e shtetit për të mitur. Organi i kujdestarisë në bashkëpunim dhe koordinim me institucionet tjera ndërmerr veprimet e caktuara në pajtim me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e fëmijëve në trajtimin e kryerësve të veprave penale nën moshën katërmëdhjetë (14) vjeç. Në afat jo më të gjatë se shtatë (7) ditë, e në raste urgjente jo më vonë se njëzet e katër (24) orë nga pranimi i informimit ose vënies në dijeni rreth kryerjes së ndonjë veprë penale të rëndë ose veprave të përsëritura, policia e informon dhe kërkon nga organi i kujdestarisë ndërmarrjen e masave urgjente adekuate për trajtimin dhe mbrojtjen e fëmijës kryerës të veprës penale. Kjo masë urgjente e ndihmës përfundon në momentin kur organi i kujdestarisë përpilon programin e rregullt për mbrojtje dhe trajtim. Me akt juridik të nxjerrë nga Qeveria e Republikës së Kosovës rregullohet mënyra e mbrojtjes së fëmijëve kryerës të veprave penale nën moshën e përgjegjësisë penale, programi i mbrojtjes, mbrojtja e fëmijës nën moshën e përgjegjësisë penale në situata urgjente, ndërmjetësimi ndërmjet bashkëmoshatarëve, ndihma juridike dhe trajtimi i kësaj kategorie të fëmijëve, gjithnjë duke u bazuar në interesin më të mirë të fëmijëve.²⁶

2.2. Deklarata për të drejtat e fëmijëve e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, më 20.11.1959

Duke pas parasysh se fëmija për shkak të mospjekurisë së tij fizike dhe mentale ka nevojë për një kujdes të posaçëm e duke përfshirë këtu edhe mbrojtjen ligjore si para edhe pas lindjes,

²⁵ Kodi Nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur, Tetor 2018, Prishtinë, neni 4.

²⁶ Kodi Nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur, Tetor 2018, Prishtinë, neni 7, parag. 1.

deklarata në fjalë i ka kushtuar rëndësi të posaçme të drejtave të fëmijëve, rëndësi kjo e cila vërehet që nga parimi nr.1. “Cdo fëmijë, pa asnjë dallim, pa asnjë përjashtim do t’i gëzojë të drejtat pa diskriminim, në racë, ngjyrë, gjini, gjuhë apo religjion, mendim politik, prejardhjen kombëtare ose shoqërore, pasuri, status të lindjes.”²⁷

2.3. Rregullat e PEKINIT (miraturar nga Asambleja e OKB-së më 29 nëntor 1985)

Rregullat e Pekinit janë miraturar nga Kongresi i VII-të i KB për parandalimin e krimit dhe trajtimin e kryerësve të mitur të veprave penale, mbajtur në Milano prej 26 gusht deri më 6 shtator 1985, miraturar nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën 40/33 të 29 shtatorit 1985, ose tërësia e rregullave minimale të Kombeve të Bashkuara lidhur me dhënien e drejtësisë për të mitur.²⁸ Standardi i dhënë i rregullave minimale ndaj të miturve të ndëshkuar zbatohet në tërësi, pa bërë përjashtim të çfarëdo lloji. Po ashtu vëmendje i kushtohet edhe parimit të të qenit i pafajshëm, respektivisht prezumimit të pafajsisë, e drejta e njoftimit për veprën e cila i ngarkohet, e drejta për mbrojtje përmes avokatit, e drejta e prezantimit të prindërve apo kujdestarit në procedurë, e drejta e ballafaqimit me dëshmitarët, e drejta në ankesë, duhet të jetë e garantuar në të gjitha instancat procedural, po ashtu edhe gjykata duhet ta shtjellojë një proces të paanshëm dhe të drejtë.²⁹ Dënimi kapital asnjëherë nuk mund të zbatohet ndaj të miturve, po ashtu në Rregullat e Pekinit hasim edhe në çështjen e lirimit me kusht, sepse më mirë është për të miturin që të lirohet me kusht se sa të vuajë dënimin, i cili do të ndikonte negativisht në personalitetin e tij.

2.4. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijëve, (miraturar nga Asambleja e Përgjithshme e KB në vitin 1989, e hyrë në fuqi më 1990)

Ndër aktet ndërkombëtare më rëndësi, lidhur me të drejtat e fëmijëve e njëherit për trajtimin e tyre sa më të mirë, paraqet edhe Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve. Obligimi i shteteve

²⁷ E miraturar nga Asambleja e Përgjithshme, më 20.11.1959.

²⁸ Rregullat e Pekinit, neni 7, parag. 1 dhe neni 15, parag. 1.

²⁹ Po aty.

anëtare është që të mbrojnë fëmijët nga çdo lloj diskriminimi. Kjo konventë rregullon edhe trajtimin e përshtatshëm procedural për të miturin, duke precizuar se nuk do t'i nënshtrohet torturës, trajtimit të egër apo dënimit, burgosjes së paligjshme dhe se duhet të jetë i veçuar nga të rriturit gjatë kohës së privimit nga liria, përveç nëse konsiderohet se është në interesin e tij. Që në preambulën e kësaj konvente vërehet gatishmëria ndaj trajtimit human të të miturve, sepse ata kanë nevojë për një tretman më të theksuar, për një mbrojtje dhe kujdes të veçantë.³⁰

3. Trajtimi i kriminalitetit të të miturve sipas të drejtës zakonore shqiptare

Ka të dhëna që tregojnë se ndaj të miturve delikuentë që në kohët ilire ka ekzistuar një kujdes i veçantë, si nga ana e prindërve ashtu edhe nga shoqëria. Në këtë kohë kujdesi ndaj delikuentëve nuk është bërë mbi baza ligjore, por është e njohur një traditë zakonore dhe moralizuese. Në këtë kohë fëmijët deri në moshën shtatë vjeçare nuk janë përgjegjës fare për një vepër të kryer, kurse ata mbi këtë moshë kanë dhënë llogari vetë apo prindërit e tyre. Sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit të gjithë njerëzit janë të barabartë. KLD si i tillë ishte i pashkruar, por ka pasur një zbatim ndër shqiptarë si në Shqipërinë e Veriut, në Lezhë, Dukagjin, Malësinë e Shkodrës, Malësinë e Gjakovës, në Kosovën Lindore, në Mal të Zi edhe në një pjesë të Maqedonisë.

Sipas KLD, mosha e kryerësit të veprës penale nuk caktohej saktë, ajo sillej rreth 12-15 vjeç dhe si përgjegjës kryesor njihje vetëm të zotin e shtëpisë, pavarësisht se ai mund të mos kishte dijeni për veprën e kryer dhe njerëzit që e kishin kryer atë vepër. Edhe pse kjo e drejtë nuk ka arritur të parashikojë shqiptimin e masave edukative, si sanksionet që shkojnë në funksion të ushtrimit të një tretmani të caktuar për të miturit, përkundrazi ka ndikuar në masë të madhe të largojë nga sistemi juridik institutin e përgjegjësisë personale të personit për krimin e kryer. E drejta zakonore shqiptare nuk ka bërë kategorizimin e të miturve e as që ka pasur ndonjë kriter të qartë sa i përket përgjegjësisë penale, por as të shqiptimit të masave adekuate edukative, sepse nuk kishte rregulla të vecanta të shkruara që do të mund të respektoheshin apo edhe të

³⁰ Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e KB në vitin 1989, e hyrë në fuqi më 1990.

zbatoheshin ndër shqiptarë.³¹ Nga e tërë kjo rrjedhë se e Drejta Zakonore nuk kishte rregulla me të cilat do të rregullohej procedura penale ndaj të miturve si procedurë e veçantë.

4. Trajtimi i kriminalitetit të të miturve sipas Ligjit mbi Drejtësinë për të Mitur i Republikës së Maqedonisë së Veriut

Sipas Ligjit mbi Drejtësinë për të Mitur të Republikës së Maqedonisë së Veriut, i mitur është çdo person deri në moshën 18 vjeç, i cili sipas Konventës për të Drejtat e Fëmijëve konsiderohet si i mitur. I mitur i ri është i mituri i cili gjatë kohës së kryerjes së veprimit që me ligj është cilësuar si vepër penale ose kundërvajtje, i ka mbushur katërmëdhjetë vjet, ndërsa nuk i ka mbushur gjashtëmbëdhjetë vjet. I mitur i rritur është i mituri i cili gjatë kohës së kryerjes së veprimit që me ligj është përcaktuar si vepër penale ose kundërvajtje, ka mbushur gjashtëmbëdhjetë vjet, ndërsa nuk i ka mbushur tetëmbëdhjetë vjet.³²

Sipas Ligjit mbi Drejtësinë për të Mitur, për një prevencion më të suksesshëm të delikuencës së të miturve themelohen këshilla shtetërore dhe këshilla komunale për preventivë. Këshilli shtetëror është i pavarur dhe i mëvetësishëm në punën e përcaktuar me këtë ligj.³³ Këshilli shtetëror i ka këto kompetenca: miraton strategji nacionale për preventivë të delikuencës së të miturve, miraton programe dhe plane vjetore për realizimin e programit, miraton rregullore për punën e vet, propozon mjete në propozimin e llogarisë buxhetore të Ministrisë së Drejtësisë të nevojshme për punën e tij, jep iniciativa për përmirësimin e akteve ligjore dhe mendime për propozimet e ligjeve me rëndësi për mbrojtjen e të drejtave për të mitur dhe pengimin e delikuencës së të miturve, ngrit iniciativa për njohjen më të gjerë të qytetarëve me të drejtat e të miturve dhe diskutime për familje të shëndoshë, për mbrojtjen e të miturve nga narkomania, alkooli dhe sëmundje tjera ngjitëse, për problemin e arsimit dhe edukimit, për sjelljen e mjeteve për informim publik dhe faktorëve të tjerë të cilët ndikojnë në parandalimin e delikuencës së të miturve, inicon hulumtime dhe studime për problemet e delikuencës së të miturve, bashkëpunon me organizata dhe trupa ndërkombëtar, të angazhuar në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe

³¹ Më gjerësisht shih Kanuni i Lek Dugagjinit, permblodhur dhe kodifikuar nga Shtejfen Gjecovi me biografi dhe parathënie të Syrja Pupovcit, Prishtinë, 1972.

³² Ligji mbi Drejtësinë për të Mitur i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 87/2008, neni 12.

³³ Ligji mbi Drejtësinë për të Mitur i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 87/2008, neni 144.

parandalimin e delikuençës së të miturve, përgatit raport vjetor për punën e vet dhe për gjendjen në fushën e të drejtave të fëmijëve dhe delikuençës së të miturve që ia dorëzon Kuvendit dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Këshillit Gjyqësor dhe Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë, që janë të detyruara t'i shikojnë dhe të ndërmarrin masa dhe aktivitete përkatëse në pajtim me kompetencat e veta, si dhe administron me mjetet e fondit për kompensimin e dëmit.³⁴

Sipas dispozitave pozitive në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ndaj delikuentëve të mitur të cilët kanë kryer vepra penale mund të shqiptohen disa lloje të masave parandaluese dhe edukative përmirësuese.

Masat disiplinore janë: qortimi gjyqësor dhe dërgimi i të miturit në qendër disiplinore. Këto masa shqiptohen ndaj kryerësit të mitur interesat e të cilit më së miri përfillen me një masë afatshkurtër, veçanërisht nëse vepra penale është kryer nga pamaturia apo pakujdesia.³⁵

Sipas Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndaj të miturve mund të shqiptohen këto masa të mbikëqyrjes së shtuar: mbikëqyrja e shtuar nga ana e prindit, nga prindi adoptues ose kujdestari i të miturit, mbikëqyrja e shtuar nga familja tjetër dhe mbikëqyrja e shtuar nga organi i kujdestarisë. Këto masa shqiptohen ndaj të miturit interesat e të cilit nuk kërkojnë izolimin nga mjedisi i tij i mëparshëm dhe mbahen me masë afatgjatë që të miturit i ofron mundësinë e edukimit, rehabilitimit apo trajtimit. Kohëzgjatja e kësaj mase nuk mund të jetë më e shkurtër se tre muaj apo më e gjatë se dy vjet.³⁶

Masat institucionale edukative ndaj të miturve janë: dërgimi i të miturit në institucionin edukues, dërgimi i të miturit në institucionin edukues korrektues dhe dërgimi i kryerësit të mitur në institucionin e kujdesit të posaçëm. Këto masa shqiptohen ndaj të miturit interesat e të cilit më së miri përfillen me veçimin e tij nga mjedisi i mëparshëm dhe me masë afatgjatë që të miturit i ofron mundësinë e edukimit, rehabilitimit apo trajtimit. Kohëzgjatja e masës edukative nuk mund të kalojë afatin maksimal të burgimit të paraparë për veprën penale. Gjykata shqipton masën e dërgimit në qendër disiplinore kur masa e tillë konsiderohet e mjaftueshme dhe në interes më të mirë të të miturit për të ndikuar pozitivisht në sjelljen e tij.³⁷

³⁴ Ismajl Zejneli, Delikuenca e të miturve, Tetovë/Prishtinë, 2018, fq. 176.

³⁵ Po aty, fq. 183.

³⁶ Kodi Penal i Rep. së Maqedonisë së Veriut, neni 77.

³⁷ Zoran Sulejmanov, Penologjia, Shkup, 2000, fq. 797.

Burgu për të mitur mund t'i shqiptohet të miturit të rritur me përgjegjësi penale, nëse ka kryer vepër penale për të cilën është paraparë dënimi me burgim prej pesë viteve ose dënimi më i rëndë dhe nëse vepra është kryer në rrethana veçanërisht rënduese me ç'rast nuk do të ishte e arsyeshme të shqiptohej masa edukative.³⁸ Burgu për të mitur nuk mund të jetë më i shkurtër se një vjet dhe më i gjatë se dhjetë vjet. Gjatë matjes së dënimit gjykata nuk mund kryerësit të veprës penale t'i shqiptojë dënim për të mitur në kohëzgjatje më shumë se dënimi i përcaktuar me burg për atë vepër.³⁹

Ndaj të miturit të rritur kryerës i përgjegjshëm i veprave penale përjashtimisht mund të shqiptohet dhe dënimi me gjobë nën kushtet e përcaktuara me Ligjin mbi kundërvajtjet. Dënimi me gjobë për kundërvajtje mund të përcaktohet në të holla e cila nuk mund të jetë më e vogël se 15 euro kundërvlerë në denarë e as më e madhe se 800 euro në kundërvlerë në denarë. Dënimin e papaguar në të holla gjykata mund ta zëvendësojë me masën punë në dobi të përgjithshme. Një gjobë ditore zëvendësohet me tre orë punë në dobi të përgjithshme, me ç'rast numri i përgjithshëm i orëve të punës në dobi të përgjithshme nuk mund të jetë më i madh se 100 orë. Dënimin e papaguar me të holla dhe punën në interes të përgjithshëm të pazbatuar dhe pjesërisht të zbatuar si zëvendësim të saj, gjykata mund ta zëvendësojë edhe me masë disiplinore, dërgim në qendrën disiplinore për të mitur ose me masë të mbikëqyrjes së përforcuar.⁴⁰

Të miturit të rritur, kryerës përgjegjës i veprave penale mund t'i shqiptohen këto masa alternative: dënimi me kusht nën mbikëqyrje mbrojtëse, ndërprerja me kusht e procedurës penale ndaj të miturve dhe puna në dobi të përgjithshme.⁴¹

Ndaj të miturit të rritur kryerës të veprave penale, i cili vuan nga çrregullime mentale në shkallë të papërgjegjshmërisë së përhershme apo me përgjegjësi të zvogëluar nën kushte të përcaktuara me ligj mund të shqiptohen këto masa të sigurisë: mjekimi i detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtja në entin shëndetësor, mjekimi i detyrueshëm psikiatrik në liri dhe mjekimi i detyrueshëm i alkookistëve dhe narkomanëve.

³⁸ Ligji mbi Drejtësinë për të Mitur i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 87/2008, neni 44.

³⁹ Kodi Penal i Rep. së Maqedonisë së Veriut, neni 87.

⁴⁰ Ligji mbi Drejtësinë për të Mitur i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 87/2008, neni 48.

⁴¹ Ligji mbi Drejtësinë për të Mitur i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 87/2008, neni 54.

Me pajtimin e të miturit, gjykata mund ta zëvendësojë masën e shqiptuar edukative institucionale deri në tre vjet, burgimin e të miturit deri në dy vjet ose gjobën me urdhër për punë në dobi të përgjithshme.

5. Trajtimi i kriminalitetit të të miturve sipas Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur të Republikës së Shqipërisë

Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur përmban rregullime të posaçme lidhur me përgjegjësinë penale të të miturve, rregulla procedurale lidhur me hetimin, ndjekjen penale, procesin gjyqësor, ekzekutimin e vendimit të dënimit penal, rehabilitimin ose të çdo mase tjetër që përfshin një të mitur në konflikt me ligjin, si dhe një të mitur viktimë dhe/ose dëshmitar të veprës penale.⁴² Parimet e këtij Kodi kanë efekt në të gjithë përmbajtjen e tij dhe zbatohen nga çdo person dhe organ kompetent në të gjitha veprimet dhe vendimet e tyre lidhur me të miturin në konflikt me ligjin, të miturin viktimë ose/dhe dëshmitar i veprës penale. Parimet e këtij Kodi zbatohen edhe në veprimet administrative të policisë dhe të organeve të tjera që kryejnë veprimtari administrative në kuadrin e drejtësisë penale për të mitur.⁴³

I mituri në konflikt me ligjin gëzon të drejtat e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale si dhe të drejtat e posaçme të parashikuara në KDM. I mituri ka të drejtë për mbrojtje dhe procedura të veçanta në të gjitha fazat e procesit të drejtësisë penale për të mitur. Në çdo fazë të procedimit penal, i mituri gëzon të drejtat e mëposhtme: të drejtën për ndihmë ligjore dhe psikologjike ose çdo ndihmë tjetër të duhur për përgatitjen dhe paraqitjen e mbrojtjes së tij; të drejtën të informohet menjëherë në formën që i përgjigjet zhvillimit individual të tij; të drejtën për një përkthyes falas/interpretues, në qoftë se nuk e kupton, nuk e flet gjuhën që përdoret ose përdor gjuhën e shenjave; të drejtën që të ketë prindin të pranishëm dhe/ose të drejtën të shoqërohet nga një person i besuar; të drejtën të mos detyrohet të dëshmojë ose të pranojë fajësinë.⁴⁴

KDM i Republikës së Shqipërisë ka paraparë masat alternative për shmangien nga ndjekja penale të cilat janë: programet e drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit; këshillimin për të

⁴² Ligji Nr. 37/2017, i Drejtësisë Penale për të Mitur i R. së Shqipërisë, neni 1 parag. 1.

⁴³ Ligji Nr. 37/2017, i Drejtësisë Penale për të Mitur i R. së Shqipërisë, neni 8.

⁴⁴ Ligji Nr. 37/2017, i Drejtësisë Penale për të Mitur i R. së Shqipërisë, neni 19.

miturin dhe familjen; paralajmërimin me gojë; paralajmërimin me shkrim; masat detyruese; vendosjen nën kujdes.⁴⁵

Ndaj të miturit, mund të caktohet si masë detyruese, që ai të ndalohej: të kontaktojë/takojë një person të caktuar, të shkojë/vizitojë një vend të caktuar; të ndryshojë vendin e banimit; të largohet nga shtëpia gjatë një periudhe/orari të caktuar; të largohet pa leje nga një vend ose nga një rajon administrativ i përcaktuar; të kryejë ndonjë veprim tjetër që pengon rishoqërimin dhe rehabilitimin e tij. Masat detyruese për të miturin janë: të fillojë ose të rifillojë studimet në një institucion arsimor; të fillojë të punojë, duke pasur parasysh dhe respektuar dispozitat e Kodit të Punës; të kryejë një program edukativ, korrigjues dhe/ose mjekësor; të përmbushë detyrime të tjera që do të përforcojnë rishoqërimin e tij dhe parandalimin e rikryerjes së veprës penale.⁴⁶

Ndaj të miturit në konflikt me ligjin mund të vendosen edhe këto masa: vendosja e të miturit në mbikëqyrje; dhe vendosja e të miturit në një shërbim të specializuar.⁴⁷

Dënimet për të miturit janë dënimet jo me burgim dhe dënimi me burgim. Në dënimet jo me burgim përfshihen: kufizimi i lirisë; qëndrimi në shtëpi; gjoba; kryerja e një pune me interes publik; ndalimi për kryerjen e një veprimtarie; përmbushja e detyrimeve të caktuara.⁴⁸

Dënimet ndaj të miturit klasifikohen në dënime kryerësore dhe plotësuese. Dënime kryerësore janë: burgimi; kufizimi i lirisë; gjoba. Dënime plotësuese janë: ndalimi për kryerjen e një veprimtarie; kryerja e një pune me interes publik; përmbushja e detyrimeve të caktuara; qëndrimi në shtëpi. Ndaj të miturit mund të jepet vetëm një dënim kryerësor. Dënimi kryerësor mund të jepet së bashku me jo më shumë se një dënim plotësues.⁴⁹

Burgimi ndaj një të mituri mund të zbatohet në rast se ai ka kryer një vepër penale për të cilën minimumi i dënimit të parashikuar është 7 vjet dhe kur ky dënim është i nevojshëm për shkak të natyrës, rrezikshmërisë së lartë shoqërore të veprës penale dhe shkallës së fajësisë. Për të miturin dënimi me burgim nuk mund të jetë më shumë se gjysma e dënimit që parashikohet për veprën penale të kryer, por jo më shumë se 12 vjet.⁵⁰

⁴⁵ Ligji Nr. 37/2017, i Drejtësisë Penale për të Mitur i R. së Shqipërisë, neni 62 parag. 1.

⁴⁶ Ligji Nr. 37/2017, i Drejtësisë Penale për të Mitur i R. së Shqipërisë, neni 68 parag. 1 dhe 2.

⁴⁷ Ligji Nr. 37/2017, i Drejtësisë Penale për të Mitur i R. së Shqipërisë, neni 82.

⁴⁸ Ligji Nr. 37/2017, i Drejtësisë Penale për të Mitur i R. së Shqipërisë, neni 95.

⁴⁹ Ligji Nr. 37/2017, i Drejtësisë Penale për të Mitur i R. së Shqipërisë, neni 96.

⁵⁰ Ligji Nr. 37/2017, i Drejtësisë Penale për të Mitur i R. së Shqipërisë, neni 97 parag. 1 dhe 2.

KPAITULLI II

LLOJET E MASAVE DHE DËNIMEVE TË CILAT MUND T’U SHQIPTOHEN TË MITURVE SIPAS KODIT TË DREJTËSISË PËR TË MITUR TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

1. Llojet e masave dhe dënimeve

Masat e diversitetit janë lloji i masave alternative të cilat parashihen në të drejtën penale bashkëkohore ndaj kryerësve të mitur të veprave penale me qëllim që të parandalojë, kur është e mundur, fillimin e procedurës ndaj kryerësit të mitur, të ndihmojë rehabilitimin pozitiv dhe riintegrimin e të miturit në bashkësinë e tij me qëllim të parandalimit të sjelljes recidiviste.⁵¹

KDM i Republikës së Kosovës ka paraparë se masat dhe dënimet e zbatueshme ndaj të miturve janë:

- Masat e diversitetit dhe masat edukative.
- Dënimet që mund të shqiptohen ndaj të miturve janë: gjoba, urdhri për punë në dobi të përgjithshme dhe burgimi për të mitur.

Dënimi nuk mund t’i shqiptohet të miturit i cili ka qenë nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjeç në kohën e kryerjes së veprës penale. Kohëzgjatja e çfarëdo mase apo dënimi të shqiptuar duhet të përcaktohet me vendim të gjykatës në pajtim me KDM-në. Kur gjykata cakton dënimin me burgim për të mitur deri në dy (2) vjet ose masën e dërgimit në institucion edukativo-korrektues deri në dy (2) vjet, mund të shqiptojë dënimin me kusht në pajtim me Kodin Penal të

⁵¹ Ismail Zejneli, Delikuenca e të miturve, Tetovë, Prishtinë, 2018, fq. 179.

Republikës së Kosovës. Përveç masës apo dënimit, të miturit mund t'i shqiptohet masa apo dënimi nga Pjesa e Dytë, Kapitulli VIII të KPRK-së.⁵²

Kur ndaj të miturit shqiptohet ndonjë masë apo dënim, gjykata në radhë të parë merr parasysh interesin më të mirë të të miturit. Gjykata gjithashtu merr parasysh edhe këto rrethana: llojin dhe peshën e veprës penale, moshën e të miturit, nivelin e zhvillimit psikologjik, karakterin e tij dhe prirjet, motivet që e nxitën atë të kryejë veprën penale, edukimin e tij në atë fazë, mjedisin dhe rrethanat e jetës së tij, nëse është shqiptuar masë apo dënim më herët dhe rrethanat tjera që mund të ndikojnë në shqiptimin e masës apo dënimit. Shërbimi sprovues përgatit anketë të plotë sociale për të miturin me kërkesë të prokurorit të shtetit për të mitur, ndërsa gjykata ashtu siç është paraparë në KDM-në. Anketa sociale përfshin të dhëna mbi moshën e të miturit dhe zhvillimin psikologjik, biografinë e familjes, biografinë dhe rrethanat nën të cilat jeton i mituri, nivelin shkollor, përvojën edukative dhe çfarëdo të dhëne tjetër relevante. Para zgjedhjes së masës apo dënimit, gjykata kërkon nga Shërbimi Sprovues raportin parandëshkues dhe mendimin lidhur me zgjedhjen e masës apo dënimit.⁵³

2. Masat e diversitetit ndaj të miturve sipas sistemit tonë penal

Si në çdo shoqëri edhe vendi ynë ndaj kategorisë së të miturve si kryerës të veprave penale ka paraparë masa të caktuara që mund të shqiptohen e që në shkencën juridike quhen masa të diversitetit. Masat e diversitetit fillimisht janë paraparë në Ligjin penal për të mitur i cili me rregulloren nr.2004/8 ka hyrë në fuqi më 20 prill 2004. Pastaj me Kodin e Drejtësisë Për të Mitur, i cili ka hyrë në fuqi me datë 8 korrik 2010, tani masat e diversitetit janë të parapara me Kodin e Drejtësisë Për të Mitur, i cili ka hyrë në fuqi me datë 14 shtator 2018. Në dispozitat hyrëse janë paraparë parimet themelore ku ruhet dinjteti, lira e shprehjes, ndihma juridike, evitimi i mundësisë së etiketimit të të miturit.

Konform zgjidhjeve më të reja në këtë drejtim, edhe Kodi i Drejtësisë për të mitur në kapitullin e III taksativisht ka paraparë qëllimin, kushtet e shqiptimit dhe llojet e masave të diversitetit. Sipas përmbajtjes së këtij Kodi, qëllimi i masave të diversitetit është parandalimi i

⁵² Kodi Nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur, Tetor 2018, Prishtinë, neni 12.

⁵³ Kodi Nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur, Tetor 2018, Prishtinë, neni 13.

mundësisë së inicimit të procedurës penale ndaj të miturit kur ai kryen vepër penale të paraparë me Kod, riintegrimi i tij në shoqëri si dhe parandalimi i tij në përsëritjen e sjelljes antiligjore.⁵⁴

KDM taksativisht ka paraparë kushtet nën të cilat mund të shqiptohen masat e diversitetit, si: pranimi i përgjegjësisë nga ana e të miturit delikuent, pëlqimi i të miturit ose i prindit, prindit adoptues ose kujdestarit në emër të të miturit për të zbatuar masën e shqiptuar të diversitetit.⁵⁵

KDM taksativisht ka paraparë se cilat masa mund t'i shqiptohen kryerësit të mitur. Bazuar në këtë, në këto masa janë:

- pajtimi në mes të kryerësit të mitur dhe palës së dëmtuar, duke përfshirë edhe kërkimfaljen nga i mituri ndaj palës së dëmtuar;
- pajtimi ndërmjet të miturit dhe familjes së tij;
- kompensimi i dëmit palës së dëmtuar në bazë të marrëveshjes së ndërsjellë ndërmjet të dëmtuarit, të miturit dhe përfaqësuesit të tij ligjor, në përputhje me situatën financiare të të miturit;
- vijimi i rregullt në shkollë;
- pranimi i punësimit apo aftësimit në një profesion adekuat me aftësitë dhe shkathhtësitë e tij;
- kryerja e punës pa pagesë në dobi të përgjithshme në pajtim me aftësinë e kryerësit të mitur për kryerjen e punës së tillë. Kjo masë mund të shqiptohet me pëlqimin e të miturit në kohëzgjatje prej dhjetë (10) deri në gjashtëdhjetë (60) orë;
- edukimi në rregullat e trafikut;
- këshillimi psikologjik;
- angazhimi në aktivitete bëmirësie;
- pagesa e një shume të caktuar e të hollave të destinuara për qëllime bëmirësie apo në programin për kompensim të viktimave në përputhje me situatën financiare të të miturit;
- angazhimi në aktivitete sportive dhe rekreative,
- këshillimi ndërmjet familjeve të të miturve;
- të përmbahet nga çfarëdo kontakti me individë të caktuar që mund të kenë ndikim negativ tek i mituri;

⁵⁴ Kodi Nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur, Tetor 2018, Prishtinë, neni 19.

⁵⁵ Kodi Nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur, Tetor 2018, Prishtinë, neni 21.

- të mos vizitojë vende ose mjedise të caktuara që mund të kenë ndikim negative tek i mituri,
- të përmbahet nga përdorimi i drogës dhe i alkoolit;
- vërejtja policore.⁵⁶

Duke u bazuar u bazuar në natyrën, kushtet e shqiptimit të këtyre masave, lirisht mund të themi se edhe shteti ynë ka përfaqësuar sistemin më modern, më human e gjithëpërfshirës si dhe më të avancuar të masave të diversitetit që mund të shqiptohen ndaj kryerësit të mitur.

3. Konsiderime të përgjithshme për rolin e zyrtarit sprovues dhe zbatimin e secilës masë të diversitetit

a) Pajtimi në mes të kryerësit të mitur dhe palës së dëmtuar, duke përfshirë edhe kërkimfaljen nga i mituri ndaj palës së dëmtuar. - Roli i zyrtarit sprovues kërkon dhe përkon me cilësitë e një ndërmjetësi të proceseve restauruese. Në këtë kapacitet ai lypset të ndjekë rregullat e mëposhtme: të inkurajojë secilën palë të rrëfejë nga këndëvështrimi i saj atë çfarë ka ndodhur, duke i dhënë mundësinë të evitojnë atë çfarë ata konsiderojnë më të rëndësishme; të dëgjojnë me kujdes, pa i imponuar palës një strukturë pyetjesh; të përpiqet të kuptojë historinë e viktimës nëpërmjet pyetjeve, reflektimit dhe përmbledhjes, duke krijuar kështu një marrëdhënie inkurajuese për pjesëmarrjen në proceset restauruese; teknikat që sugjerohen të përdoren në këto raste janë ato të pyetjeve të hapura, pohimeve, dëgjimit reflektues dhe përmbledhjes, duke shmangur udhëheqjen e bisedës.⁵⁷ Zyrtari sprovues duhet të mbajë parasysh vështirësitë që paraqet vetë procesi i pajtimit pasi që të miturit apo të rinjtë po ftohen të takojnë persona me të cilët ata janë në konflikt. Gjithashtu, zyrtari sprovues duhet të mbajë parasysh se njerëzit e tjerë të përfshirë në process janë në përgjithësi të rritur dhe se palët janë ftuar në takim për të folur për diçka, që me shumë gjasa u ka shkaktuar zemërim, frikë, ankth dhe turp. Kjo do të jetë një ngjarje shumë sfiduese për shumicën e të miturve. Ata kanë nevojë për mbështetje dhe përgatitje për të dëgjuar zërin e tyre.⁵⁸

b) Pajtimi ndërmjet të miturit dhe familjes së tij. - Zyrtari sprovues në rastin e zbatimit të masës së pajtimit familjar mund të përballlet me sfidën e të qenit një i huaj - “the outsider” dhe

⁵⁶ Kodi Nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur, Tetor 2018, Prishtinë, neni 20.

⁵⁷ Udhëzues mbi zbatimin e masave të diversitetit për të miturit nga Shërbimi Sprovues i Kosovës, Prishtinë, 2019, fq. 21.

⁵⁸ Po aty, fq. 24.

palët realisht të tregojnë një mungesë të theksuar dëshire për të bashkëpunuar apo për ta trajtuar këtë çështje si një proces, i cili ka nevojë për përfshirjen e tij. Në këtë kuadër është e rëndësishme që zyrtari sprovues të tregojë pse është e rëndësishme që të gjitha palët të diskutojnë dhe procesi i pajtimit të jetë i vërtetë, i ndjerë, të nxitë ndjenjën e përgjegjësisë tek i mituri kryerës dhe e cila nga ana tjetër të stimulojë ndjenjën e faljes dhe të pajtimit të vërtetë në rrafshin emocional dhe kognitiv mes palëve. Zyrtari sprovues ka për detyrë të lehtësojë diskutimin e çështjeve të vështira dhe të realizojë një plan për t'i adresuar ato.⁵⁹ Kjo metodë ka rezultuar shumë e suksesshme në parandalimin e përkeqësimit të problemeve të ndryshme me të cilat përballen si i mituri kryerës, por edhe prindërit apo të miturit e tjerë të familjes, të cilët mund të mos kenë aftësitë e duhura për të artikuluar dhe verbalizuar qartë përjetimet, nevojat dhe dëshirat e tyre, thekësojnë zyrtarët nga shërbimi sprovues.

c) Kompensimi i dëmit palës së dëmtuar në bazë të marrëveshjes së ndërsjellë ndërmjet të dëmtuarit, të miturit dhe përfaqësuesit të tij ligjor, në përputhje me situatën financiare të të miturit. - Tek kjo masë, roli i zyrtarit sprovues duhet të jetë i fokusuar kryesisht në monitorimin e pagimit të dëmit nga kryerësi i mitur, ashtu siç parashikohet në marrëveshje, duke marrë në këtë mënyrë rolin e një përmbaruesi gjyqësor, por kjo me gjithë disa elemente të vërteta në fakt nuk është plotësisht kështu. Roli i vërtetë i zyrtarit sprovues është të verifikojë nevojat dhe të adresojë të gjitha elementet, të cilat mund të rrezikojnë zbatimin e marrëveshjes, siç mund të jetë humbja e punësimit, apo punësimi sezonal i papërsëritur, çka do të çonte në moszbatimin e marrëveshjes. Vështirësitë ekonomike dhe financiare të familjes së të miturit janë një çështje tjetër, e cila vlen të verifikohet në kuadër të zbatimit të kësaj mase.⁶⁰

d) Vijimi i rregullt në shkollë. - Në kuadër të zbatimit të kësaj mase, zyrtari sprovues nevojitet të evidentojë qasjen e të miturit kryerës ndaj shkollës pas marrjes së masës së diversitetit, vështirësitë dhe përjetimet e tij në lidhje me rifillimin apo vazhdimin e shkollës, kushtet dhe rrethanat që mund të bëhen pengesë për frekuentimin e shkollës, të cilat mund të lidhen me mësuesit, me administratën e shkollës, me të miturit e tjerë në shkollë.⁶¹

e) Pranimi i punësimit apo aftësimit në një profesion adekuat me aftësitë dhe shkathhtësitë e tij. - Roli i zyrtarit sprovues tek kjo masë është shumë kyç, pasi është a i cili duhet ta përshtatë

⁵⁹ Udhëzues mbi zbatimin e masave të diversitetit për të miturit nga Shërbimi Sprovues i Kosovës, Prishtinë, 2019, fq. 27.

⁶⁰ Po aty, fq. 29.

⁶¹ Po aty, fq. 31.

llojin e punësimit apo të aftësimit më profesional me dëshirën, kapacitetin dhe prirjet e të miturit, për të shmangur që detyrimi i marrë përsipër në kuadër të masës së diversitetit të jetë vetëm formal dhe të shërbejë vetëm për shmangien e hapjes së procedurës penale.⁶²

f) Kryerja e punës pa pagesë në dobi të përgjithshme në pajtim me aftësinë e kryerësit të mitur për kryerjen e punës së tillë. - Kjo masë mund të shqiptohet me pëlqimin e të miturit në kohëzgjatje prej dhjetë (10) deri në gjashtëdhjetë (60) orë. Pas njoftimit të shërbimit sprovues nëpërmjet aktvendimit për masën me punë në dobi të përgjithshme është thelbësor një menaxhim efektiv dhe gjithëpërfshirës. Zyrtari sprovues, i cili vepron edhe si menaxher i rastit, duhet të informojë dhe të përshtatë punën dhe llojin e institucionit pranë të cilit do të punësohet i mituri, me nevojat, dëshirat, prirjet, aftësitë dhe vendndodhjen e të miturit.⁶³

g) Edukimi në rregullat e trafikut. - Zyrtari sprovues në këtë rast duhet të luajë rolin e lehtësuesit dhe të koordinuesit mes të miturit dhe agjencionit, qendrës, shoqatës që ofron kurse të edukimit në rregullat e trafikut. Nëse nuk ekzistojnë agjencione shtetërore, të cilat ofrojnë këtë lloj edukimi, atëherë është e nevojshme të evidentohen agjencione private sa më pranë zoneë ku banon i mituri, duke lehtësuar kështu aksesin dhe duke ulur koston e transportit për të kryer këtë detyrim të marrë përsipër nga i mituri në kuadër të masës së diversitetit.⁶⁴

h) Këshillimi psikologjik. - Zyrtari sprovues është shumë e rëndësisishme të lehtësojë dhe të mbështesë të miturin për të realizuar me sukses këtë masë diversiteti, duke e parë rolin e tij jo vetëm si lehtësues të procesit të referimit dhe të koordinimit mes të miturit dhe ofruesve të shërbimit psikologjik, por edhe të ndihmës konkrete për të miturin për të përballuar sfidat me të cialt ai përballlet në realizimin e kësaj mase.⁶⁵

i) Angazhimi në aktivitete bëmirësie. - Zyrtari sprovues duhet të ketë parasysh se i mituri mund ta përjetojë zbatimin e kësaj mase me ndjesi turpi apo si një gjë që ai e ka pranuar për ta bërë vetëm që të shmangë përballjen me drejtësinë dhe dënimin pa pasur reflektimin e duhur dhe pa e përjetuar me ndjenjën e përgjegjësisë këtë masë.⁶⁶

j) Pagesa e një shume të caktuar e të hollave të destinuara për qëllime bëmirësie apo në programin për kompensim të viktimave në përputhje me situatën financiare të të miturit. - Është

⁶² Udhëzues mbi zbatimin e masave të diversitetit për të miturit nga Shërbimi Sprovues i Kosovës, Prishtinë, 2019, fq. 33.

⁶³ Po aty, fq. 36.

⁶⁴ Po aty, fq. 39.

⁶⁵ Po aty, fq. 42.

⁶⁶ Po aty, fq. 44.

e rëndësishme që zyrtari sprovues ta kontaktojë të miturin, ta intervistojë atë dhe të mundohet të identifikojë nëse ekziston ndonjë vështirësi apo sfida në lidhje me zbatimin e masës me qëllim adresimin e nevojave për të kapërcyer vështirësitë e arritjes së zbatimit të suksesshëm të masës.⁶⁷

k) Angazhimi në aktivitete sportive dhe rekreative. - Zyrtari sprovues duhet të identifikojë dëshirat dhe priirjet e të miturit si dhe të evidentojë qendrat e mundshme pranë të cilave i mituri do të mund të regjistrohet për të kryer këtë masë diversiteti.⁶⁸

l) Këshillimi ndërmjet familjeve të të miturve. - Zyrtari sprovues sugjerohet që në varësi të situatës pas realizimit të një vlerësimi paraprak të gjendjes, qasjes dhe përjetimeve të të miturve të përfshirë në konflikt dhe vetë familjarëve të tyre, të vlerësohet nëse këshillimi në këto raste mund të kryhet nga vetë zyrtari sprovues apo do të duhet të kërkohet angazhimi i profesionistëve të fushës, punonjës socialë apo psikologë për të realizuar një qasje dhe trajtim më profesional. Kjo do t'i shërbente riparimit të marrëdhënieve në aspektin afatgjatë, duke krijuar premisë për marrëdhënie të vërteta e të shëndosha dhe jo sipërfaqësore sa për të realizuar zbatimin e masës së diversitetit.⁶⁹

ll) Të përmbahet nga çfarëdo kontakti me individë të caktuar që mund të kenë ndikim negativ tek i mituri. - I mituri duhet të fuqizohet për t'u rezistuar thirrjeve apo kontaktimit të palës tjetër, e cila nuk ka detyrim për t'u përmbajtur, nëse një gjë e tillë ndodh, i mituri duhet të informohet për mundësinë që t'i raportojë zyrtarit sprovues kontaktimin nga zyrtari tjetër, i cili mund të kontaktohet më pas nga zyrtari sprovues, duke i kërkuar atij të mos cenojë të miturin dhe të lejojë zbatimin korrekt të masës së diversitetit.⁷⁰

m) Të mos vizitohet vende ose mjedise të caktuara që mund të kenë ndikim negativ tek i mituri. - Detyra parësore e zyrtarit sprovues është të ndërgjegjësojë të miturin në lidhje me efektet negative të frekuentimit të këtyre mjediseve, papërshtatshmërisë së tyre për të miturin, influencës negative që kanë luajtur ato në përfshirjen e të miturit në veprën penale, pasojat eventuale që mund të vijnë nga moszbatimi i masës apo ripërfshirja e të miturit në krim.⁷¹

n) Të përmbahet nga përdorimi i drogës dhe i alkoolit. - Zyrtari sprovues nevojitet të verifikojë situatën e të miturit në lidhje me përdorimin dhe nivelin e varësisë që ka krijuar i

⁶⁷ Udhëzues mbi zbatimin e masave të diversitetit për të miturit nga Shërbimi Sprovues i Kosovës, Prishtinë, 2019, fq. 46.

⁶⁸ Po aty, fq. 47.

⁶⁹ Po aty, fq. 50.

⁷⁰ Po aty, fq. 52.

⁷¹ Po aty, fq. 54.

mituri nga përdorimi i tyre, në mënyrë që të ketë mundësi ta mbështesë atë nëse është e nevojshme, duke e regjistruar në programe të caktuara që ndihmojnë të miturin sidomos në fazën e abstinencës nga përdorimi i substancave narkotike apo përdorimi i alkoolit.⁷²

nj) Vërejtja policore. - Zyrtari sprovues duhet të kontaktojë të miturin, të verifikojë qasjen dhe përjetimet e të miturit në lidhje me veprën penale, planet dhe qasjen e tij për të ardhmen, të verifikojë nëse ekzistojnë çështje, situata, kushte të caktuara që mund të përbëjnë rrezik apo premisa që i mituri të përfshihet sërish në krim.⁷³

Mendohet se gjatë zbatimit të masave të diversitetit, zyrtari sprovues duhet të ketë parasysh këto konsiderime:

- të parafranojë pyetjet që mund të keqkuptohen;
- të përdorë gjuhë të kuptueshme lehtësisht për të miturit;
- të kuptohet botëkuptimi i tyre në lidhje me jetën e tyre që është e ndryshme nga jeta e një madhori;
- t'i japë informacion të miturit në lidhje me pasojat e moszbatimit të masës e cila i është shqiptuar;
- ta këshillojë të miturin me qëllim ndërgjegjësimin e tij për efektet negative nga përdorimi i substancave të ndryshme etj.

4. Masat edukative

Masat edukative, si sanksione të veçanta penale ndaj të miturve, kanë për qëllim në radhë të parë pengimin e veprimit kriminal të delikuentëve të mitur, por edhe riedukimin, riintegrimin dhe përgatitjen e tyre për jetë.⁷⁴ Qëllimi i masave edukative është dhënia e ndihmës dhe mbikëqyrjes së kryerësve të mitur të veprave penale me qëllim të risocializimit dhe edukimit të tyre.⁷⁵

⁷² Udhëzues mbi zbatimin e masave të diversitetit për të miturit nga Shërbimi Sprovues i Kosovës, Prishtinë, 2019, fq. 56.

⁷³ Po aty, fq. 59.

⁷⁴ Ragip Halili, Penologjia, Prishtinë, 2010, fq. 255.

⁷⁵ Ismail Zejneli, Delikuenca e të miturve, Tetovë/Prishtinë, 2018, fq. 173.

KDM ka paraparë se qëllimi i masës edukative është që të kontribuojë në rehabilitimin dhe zhvillimin adekuat të kryerësit të mitur, duke ofruar mbrojtje, ndihmë dhe mbikëqyrje, duke siguruar edukim dhe aftësim profesional, duke zhvilluar përgjegjësinë e tij personale dhe kështu duke ndaluar sjelljen recidiviste.⁷⁶ Masat edukative si lloje të posaçme të sanksioneve penale manifestojnë disa karakteristika të cilat ato i bëjnë të dallueshme prej dënimeve dhe sanksioneve të tjera penale. Si karakteristika të masave edukative konsiderohen:

- Organi që i shqipton. - Këto masa mund të shqiptohen vetëm nga gjykata kompetente, dhe atë vetëm ndaj të miturve që kanë kryer vepra penale;⁷⁷
- Zbatimi i detyrueshëm. - Këto masa zbatohen me detyrim, në rastet kur nuk kemi zbatim të vullnetshëm të tyre;
- Kufizueshmëria e të drejtave dhe lirive themelore. - Disa prej tyre, siç janë masat edukative institucionale, bëjnë kufizimin e disa të drejtave dhe lirive të të miturve;
- Bazuar në faktin se vendosja e tyre në një institucion nënkupton edhe respektimin e regjimit që ai aplikon në veprimtarinë e tij;⁷⁸
- Kategoria e kryerësve të veprave penale ndaj të cilëve mund të shqiptohen. - Këto masa mund t'u shqiptohen vetëm kryerësve të mitur të veprave penale të cilët përjashtohen nga shqiptimi i dënimit ose kur kjo bëhet për shkak të moshës së tyre (14-16 vjeç);
- Karakteri fakultativ i shqiptimit. - Kjo do të thotë se gjykata kompetente nuk është e detyruar që çdo të mituri për të cilin plotësohen kushtet ligjore për shqiptimin e tyre t'ia shqiptojë ato. Kur gjykata vlerëson se është në interesin më të mirë të të miturit që të mos i shqiptohen masat edukative ajo nuk ia shqipton ato;
- Mbikëqyrja e zbatimit. - Këto masa i nënshtrohen mbikëqyrjes së gjykatës. Kështu, gjykata është e detyruar që sipas detyrës zyrtare të kujdeset që ekzekutimi i masave të tilla të reflektojë në kuptim të realizimit të qëllimit të tyre;⁷⁹
- Revokueshmëria e vendimit gjyqësor mbi shqiptimin e masës edukative. - Aktvendimi i gjykatës mbi shqiptimin e masës edukative mund të revokohet në çdo kohë kur pushojnë

⁷⁶ Kodi Nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur, Tetor 2018, Prishtinë, neni 22.

⁷⁷ Peza, N. & Elezi I. & Gjika, Gr etj. E drejta penale e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë (Pjesa e përgjithshme), Tiranë, 1982, fq. 289.

⁷⁸ Muçi, Sh. E drejta penale (Pjesa e përgjithshme, Tiranë, 2007, fq. 261.

⁷⁹ Për disa prej masave edukative (siç është rasti me mbikëqyrjen e shtuar nga ana e organit të kujdestarisë) parashihet detyrimi i organeve përkatëse që ta informojnë gjykatën në periudha të caktuara kohore lidhur me ekzekutimin e vendimit gjyqësor.

rrethanat mbi bazën e të cilave janë shqiptuar ato. Revokimi mund të bëhet ex officio (kryesisht) ose me kërkesë të palës së interesuar (p.sh., prindit të të miturit) ose personit përgjegjës të institucionit ku bëhet ekzekutimi i masës përkatëse;⁸⁰

- Mungesa e pasojave juridike. - Masat e shqiptuara edukative nuk manifestojnë kurrfarë pasojë juridike për të miturin ndaj të cilit janë shqiptuar ato. Kështu, të miturit ndaj të cilëve janë shqiptuar këto masa nuk regjistrohen fare në regjistrin e personave të ndëshkuar.⁸¹

Kodi i Drejtësisë për të Mitur ka paraparë gjithsej tetë masa edukative, nga të cilat janë:

- qortimi gjyqësor,
- masat e mbikëqyrjes së shtuar dhe
- masat institucionale.⁸²

Qortimi gjyqësor shqiptohet ndaj të miturit, interesat e të cilit më së miri përfillen me një masë afatshkurtër, veçanërisht nëse vepra penale është kryer nga pamaturia apo pakujdesia.

Masat e mbikëqyrjes së shtuar, janë:

- mbikëqyrja e shtuar nga ana e prindit, nga prindi adoptues ose kujdestari i të miturit,
- mbikëqyrja e shtuar nga familja tjetër dhe mbikëqyrja e shtuar nga organi i kujdestarisë.

Këto masa shqiptohen ndaj të miturit interesat e të cilit nuk kërkojnë izolimin nga mjedisi i tij i mëparshëm dhe mbahen me masë afatgjatë që të miturit i ofron mundësinë e edukimit, rehabilitimit apo trajtimit. Kohëzgjatja e kësaj mase nuk mund të jetë më e shkurtër se tre (3) muaj apo më e gjatë se dy (2) vjet.⁸³

Masat institucionale edukative janë:

- dërgimi i të miturit në institucion edukues korrektues dhe
- dërgimi i të mitur në institucionin e kujdesit të posaçëm.

Këto masa shqiptohen ndaj të miturit interesat e të cilit më së miri përfillen me veçimin e tij nga mjedisi i mëparshëm dhe me masë afatgjatë, që të miturit i ofron mundësinë e edukimit,

⁸⁰ Enkelejda Turkeshi, Masat edukative të parashikuara në Kodin Penal dhe zbatimi i tyre në Shqipëri, Revista Shqiptare për Studime Ligjore, Vol. 4, nr. 1, Tiranë, 2011. e qasshëme në: http://www.ajls.org/doc/4_ETurkeshi_Takimi_V.pdf, fq. 34.

⁸¹ Po aty.

⁸² Kodi Nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur, Tetor 2018, Prishtinë, neni 23, parag. 1.

⁸³ Kodi Nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur, Tetor 2018, Prishtinë, neni 23, parag. 3.

rehabilitimit apo trajtimit. Kohëzgjatja e masës edukative nuk mund të kalojë afatin maksimal të burgimit të paraparë për veprën penale.⁸⁴

Rast praktik nga puna:

Masa edukative “Mbikëqyrja e shtuar nga ana e prindërve dhe SHSK-së”

I mituri 17 vjeç, në gjendje të rëndë socio-ekonomike, por edhe shëndetësore, meqë vuan nga një sëmundje e rëndë. Gjykata Komunale në Gjiilan, i ka shqiptuar masën edukative “mbikëqyrje e shtuar nga ana e prindërve dhe SHSK-së”, në kohëzgjatje një vit, për shkak të kryerjes së veprës penale “vjedhje pylli”, sipas nenit 285 parag. 1 i KPK-së. Masa e mbikëqyrjes ka filluar nga data 06.04.2012 dhe ka zgjatur deri me datë 06.04.2013. Kjo masë është ekzekutuar nga na e drejtorisë regjionale në Gjiilan në bashkëpunim me të miturin dhe prindërit e tij. Për shkak të gjendjes së rëndë socio-ekonomike, familja e të miturit nuk ka qenë në gjendje që t’ia sigurojë shpenzimet e udhëtimit për shkollimin e mesëm. Andaj për këtë arsye i mituri e ka ndërprerë mësimin pas kryerjes së klasës së dhejtë. Falë një donacioni të UNICEF-it, i cili është i dedikuar për rastet e të miturve me gjendje të rëndë ekonomike, i mituri ka përfituar një ndihmë simbolike dhe në këtë mënyrë është përkrahur, respektivisht i janë siguruar shpenzimet e udhëtimit për tre muaj. I mituri tani ndjekë mësimet në klasën e XI në shkollën e mesme dhe është i motivuar dhe inkurajuar që ta kryejë shkollën me kohë. Kjo mundësi e ofruar nga UNICEF-I, në bashkëpunim me shërbimin sprovues i ka ndihmuar të miturit në procesin e riintegrit në shoqëri, përkatësisht në rrethin ku jeton.

Q.M.

Zyrtar Sprovues/Gjiilan

5. Gjoha dhe urdhëri për punë në dobi të përgjithshme

KDM ka paraparë se gjykata mund të shqiptojë dënim me gjobë ndaj të miturit nëse i mituri ka mjete për ta paguar gjobën. Me rastin e shqiptimit të dënimit me gjobë, gjykata shqyrton gjendjen financiare të të miturit dhe në veçanti lartësinë e të ardhurave të tij personale,

⁸⁴ Kodi Nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur, Tetor 2018, Prishtinë, neni 23, parag. 4 dhe 5.

të ardhurat tjera, pasurinë dhe detyrimet. Gjykata nuk e cakton lartësinë e gjobës mbi lartësinë e mjeteve që posedon i mituri. Dënimi me gjobë nuk mund të jetë më pak se njëzetepesë (25) Euro ose më shumë se pesëmijë (5.000) Euro. Me aktgjykim përcaktohet afati për pagesën e gjobës i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se pesëmbëdhjetë (15) ditë e as më i gjatë se tre (3) muaj, por në rrethana të arsyeshme gjykata mund të lejojë pagesën e gjobës me këste, por jo më gjatë se dy (2) vjet. Nëse i mituri nuk dëshiron apo nuk mund ta paguajë gjobën, gjykata mund të lejojë që gjoba të paguhet me këste, por jo më gjatë se dy (2) vjet. Pastaj, nëse i mituri përsëri nuk dëshiron apo nuk mund ta paguajë gjobën, gjykata, me pëlqimin e personit të dënuar, mund ta zëvendësojë gjobën me urdhër për punë në dobi të përgjithshme që nuk pengon vijimin e rregullt në shkollë dhe aktivitetet e tjera të punës. Gjykata mund ta zëvendësojë dënimin me gjobë me ndonjë masë edukative jo institucionale, siç është përcaktuar me dispozitat përkatëse të KDM-së, nëse i mituri nuk e paguan dënimin me gjobë e as nuk pajtohet me zëvendësimin e saj me urdhërin me punë në dobi të përgjithshme.⁸⁵

Puna në dobi të përgjithshme është masë alternative që përbëhet në punë të detyrueshme të papaguar, numër i përcaktuar i orëve të lira të kryerësit në dobi të përgjithshme.⁸⁶

KDM ka paraparë se Gjykata mund ta shqiptojë dënimin urdhër me punë në dobi të përgjithshme. Kur e shqipton urdhrin për punë në dobi të përgjithshme, gjykata e urdhron të miturin që të kryejë punë në dobi të përgjithshme pa pagesë për një afat të caktuar prej tridhjetë (30) deri në njëqind e njëzet (120) orëve. Me pajtimin e të miturit, gjykata mund ta zëvendësojë masën e shqiptuar edukative institucionale deri në tre (3) vjet, burgimin e të miturit deri në dy (2) vjet ose gjobën me urdhër për punë në dobi të përgjithshme. Shërbimi sprovues e përcakton llojin e punës në dobi të përgjithshme të cilën duhet ta kryejë personi i dënuar, cakton organizatën specifike për të cilën personi i dënuar do ta kryejë punën në dobi të përgjithshme, vendos për ditët e javës kur do të kryhet puna dhe mbikëqyrë kryerjen e punës në dobi të përgjithshme. Shërbimi sprovues përkujdeset që ekzekutimi i punës në dobi të përgjithshme mos të ndikojë në ndërprerjen e shkollimit apo të ndonjë punësimi të rregullt të të miturit. Puna në dobi të përgjithshme e shqiptuar nga gjykata, duhet të ekzekutohet brenda një (1) viti. Nëse pas kalimit të periudhës së caktuar i mituri nuk e kryen punën në dobi të përgjithshme ose punën e tillë në dobi të përgjithshme e kryen vetëm pjesërisht, gjykata urdhron ekzekutimin e burgimit për të

⁸⁵ Kodi Nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur, Tetor 2018, Prishtinë, neni 31.

⁸⁶ Vllado Kambovski, E drejta penale e përgjithshme, Shkup 2010, fq. 26.

mitur në kohëzgjatje proporcionale, duke marrë parasysh kohëzgjatjen e punës në dobi të përgjithshme që është kryer. Në raste të tilla, Gjykata nuk është e kushtëzuar nga kohëzgjatja minimale prej një (1) viti për masën e edukimit institucional e as kohëzgjatja prej gjashtë (6) muaj dënim me burg, të përcaktuara me KDM-në.⁸⁷

6. Burgimi për të mitur

Lufta kundër delikuencës së të miturve nuk mund të udhëhiqet në masë të njëjtë dhe me mjete të njëjta sikurse edhe ndaj kryerësve të rritur të veprave penale si dhe llojet e sanksioneve nuk mund të shqiptohen njësoj sikurse ndaj të rriturve. Ndaj kryerësve të mitur të veprave penale burgu për të mitur shqiptohet vetëm në rastet kur vepra penale është e rrezikshmërisë së lartë shoqërore dhe për shkak të rrethanave të kryerjes së veprës dhe cilësisë së kryerësit të veprës penale.⁸⁸

KDM ka paraprë se qëllimi i burgimit për të mitur është që të kontribuohet në rehabilitimin, risocializimin dhe në zhvillimin e kryerësit të mitur, veçanërisht në edukimin e të miturit, edukimin e specializuar, aftësitë profesionale dhe në zhvillimin e duhur personal. Përveç kësaj, burgimi për të mitur duhet të ndikojë pozitivisht në të miturin përmes mbrojtjes, ndihmës dhe mbikëqyrjes për ta parandaluar recidivizmin.⁸⁹

Gjykata mund të shqiptojë dënimin me burgim për të mitur ndaj kryerësit të mitur i cili në kohën e kryerjes së veprës penale i ka mbushur gjashtëmbëdhjetë (16) vjet dhe ka kryer vepër penale të dënueshme me mbi pesë (5) vite burgim, në rastet kur shqiptimi i masës edukative nuk do të ishte adekuat për shkak të peshës së veprës penale, pasojave të saj dhe shkallës së përgjegjësisë penale.⁹⁰

KDM ka përcaktuar se kohëzgjatja e burgimit për të mitur nuk mund ta kalojë maksimumin e burgimit të paraparë për veprën penale, por mund të jetë më i ulët se minimumi i burgimit të paraparë për veprën penale. Burgimi për të mitur nuk mund të shqiptohet në kohëzgjatje më pak se gjashtë (6) muaj e as më shumë se pesë (5) vjet dhe shqiptohet në muaj

⁸⁷ Kodi Nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur, Tetor 2018, Prishtinë, neni 32.

⁸⁸ Ismail Zejneli, Delikuenca e të miturve, Tetovë/Prishtinë, 2018, fq. 194.

⁸⁹ Kodi Nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur, Tetor 2018, Prishtinë, neni 33.

⁹⁰ Kodi Nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur, Tetor 2018, Prishtinë, neni 34.

dhe vite të plota. Përgjatë, maksimumi i burgimit për të mitur është dhjetë (10) vjet për vepra të rënda penale të dënueshme me burgim të përjetshëm, ose kur i mituri ka kryer së paku dy (2) vepra penale në bashkim, ku secila është e dënueshme me burgim prej më shumë se dhjetë (10) vjet. Kur gjykata vendos për kohëzgjatjen e burgimit për të mitur, merr parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara me KDM-në dhe KPRK-ës.⁹¹

Po ashtu, KDM i Republikës së Kosovës ka paraparë se personi i dënuar me burgim për të mitur mund të lirohet me kusht nëse e ka mbajtur së paku një të tretën (1/3) e dënimit që i është shqiptuar. Kur lejohet lirimi me kusht, gjykata mund të shqiptojë masën e mbikëqyrjes së shtuar nga ana e prindit, prindit adoptues ose kujdestarit apo organit të kujdestarisë i cili mund të zgjasë deri në përfundim të dënimit të shqiptuar. Gjykata mund të revokojë lirin me kusht nëse gjatë kohës së lirit me kusht i mituri kryen vepër penale për të cilën shqiptohet burgimi ose burgimi për të mitur prej së paku gjashtë (6) muajve.⁹²

Për vepra penale në bashkim KDM ka përcaktuar se gjykata shqipton vetëm një masë edukative ose vetëm një dënim kur kushtet ligjore për shqiptimin e dënimit të tillë janë përmbushur dhe gjyqtari kompetent konstaton se ai duhet të shqiptohet. Kjo zbatohet edhe në rastet kur i mituri ka kryer vepër tjetër penale para ose pas shqiptimit të masës edukative ose të dënimit.⁹³

7. Masat e trajtimit të detyrueshëm dhe dënimet plotësuese

Në shkencën e kriminologjisë flitet shumë për ndikimin e sëmundjeve dhe çrregullimeve mentale, si dhe të drogës dhe alkoolit në sjelljet delikuede të njerëzve. Të gjitha këto trajtohen si faktor që kanë ndikim të fuqishëm si në kriminalitetin e madhorëve, po ashtu edhe të të miturve.⁹⁴ Madje, në disa raste, te disa persona me paaftësi mendore dhe varësi nga droga e alkooli, këto situata janë shkaktarë kryerësorë të kryerjes së veprës penale.⁹⁵ Për të evituar rrezikun që personat e këtillë në të ardhmen të kryejnë vepra penale, është parë e domosdoshme

⁹¹ Kodi Nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur, Tetor 2018, Prishtinë, neni 35.

⁹² Kodi Nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur, Tetor 2018, Prishtinë, neni 36.

⁹³ Kodi Nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur, Tetor 2018, Prishtinë, neni 37.

⁹⁴ Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2011, fq. 362.

⁹⁵ Vasilika Hysi, Kriminologjia, Tiranë, 2010, fq. 373.

që krahas dënimit të shqiptohet edhe masa e trajtimit, mjekimit të detyrueshëm. Ndërsa ndaj personave tërësisht të papërgjegjshëm për shkak të çrregullimeve mendore, shqiptohen vetëm masat e trajtimit të detyrueshëm. Mundësia e shqiptimit të masave të trajtimit të detyrueshëm ndaj kryerësve madhorë të veprave penale është paraparë me nenet 83-87 të Kodit Penal.

Sipas Kodit Penal të Kosovës masat e trajtimit të detyrueshëm nuk janë sanksione penale, por janë masa të posaçme, masa “sui generis” të karakterit mjekësor, të cilat mund t’u shqiptohen vetëm kryerësve të veprave penale më paaftësi mendore, me aftësi esencialisht të zvogëluar mendore dhe në varësi nga droga dhe alkooli.⁹⁶ Për shkak të natyrës dhe qëllimeve të tyre, masat e trajtimit të detyrueshëm në Kodin Penal janë tërësisht të ndara nga sistemi dhe llojet e sanksioneve penale.

Me anë të masave të trajtimit të detyrueshëm ndaj kryerësve të veprave penale me çrregullime mendore ose në varësi të drogës dhe alkoolit, të drejtat penale bashkëkohore kanë për qëllim që të kontribuojnë në rehabilitimin, mjekimin e personave të këtillë dhe që të evitojnë rrezikun e recidivizmit, që sërish të mos kryejnë vepra penale.⁹⁷ Qëllimi i tillë është paraparë shprehimisht në paragrafin 1 të nenit 38 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur. Në këtë dispozitë thuhet se “Qëllimi i masës së trajtimit të detyrueshëm është që të kontribuojë në rehabilitimin e të miturit dhe të parandalojë rrezikun nga recidivizmi”.

Konform paragrafit 1 të nenit 38 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur masat e trajtimit të detyrueshëm ndaj të miturve shqiptohen në pajtim me dispozitat e Kodit Penal. Me këto dispozita janë rregulluar parimet, qëllimet, kushtet dhe llojet e shqiptimit të masave të trajtimit të detyrueshëm.⁹⁸ Nga kjo rezulton se personave të mitur të cilët në kohën e kryerjes së veprës penale kanë qenë me çrregullime mendore apo në varësi të drogës apo alkoolit, sikundër edhe për personat madhorë, ndaj tyre mund të shqiptohen masat e trajtimit të detyrueshëm të parapara në Kodin Penal të Republikës së Kosovës. Gjithashtu, edhe në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës është paraparë procedurë e veçantë gjyqësore për shqiptimin e tyre.⁹⁹ Është rregull parimor që këto masa gjykata t’i shqiptojë duke marrë parasysh personalitetin e të miturit, llojin dhe intensitetin e çrregullimit mendor të tij dhe kërkesat e Kodit të Drejtësisë për të Mitur që kanë të bëjnë me shqiptimin e masave edukative dhe dënimeve për të mitur.

⁹⁶ Kodi 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës, Janar, 2019, Prishtinë, neni 84, parag. 1.

⁹⁷ Ismet Salihu, E drejta penale për të mitur, Prishtinë, 2005, fq. 86.

⁹⁸ Kodi 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës, Janar, 2019, Prishtinë, nenet 87-91.

⁹⁹ Kodi 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës, Janar, 2019, Prishtinë, nenet 503-518.

Në Kodin Penal të Republikës së Kosovës parashihen tri lloje të masave të trajtimit të detyrueshëm të cilat mund të shqiptohen ndaj kryerësve të veprave penale, përfshirë delikuentët e mitur. Këto masa janë:

- trajtimi detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor;
- trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri dhe
- trajtimi me anë të rehabilitimit të detyrueshëm të personave të varur nga droga ose alkooli.¹⁰⁰

Kur gjykata e konsideron të arsyeshme mund të shqiptojë dënimin plotësues në pajtim me nenin 64 dhe 69 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Dënimet plotësuese sipas nenit 62 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, mund t'i shqiptohen madhorit të ri kur gjykohet sipas nenit 16 të KDM-së.¹⁰¹

¹⁰⁰ Kodi 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës, Janar, 2019, Prishtinë, neni 84.

¹⁰¹ Kodi Nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur, Tetor 2018, Prishtinë, neni 39.

KAPITULLI III

FAKTORËT E PARAQITJES SË DELIKUENCËS SË TË MITURVE

1. Vështrime të përgjithshme lidhur me faktorët e paraqitjes të delikuencës së të miturve

Pavarësisht se nuk ekziston ndonjë zgjidhje e mirëfilltë për parandalimin, apo korrektimin e delinkuencës së të miturve, identifikimi i faktorëve të riskut dhe të atyre mbrojtës është esencial për të zhvilluar ndërhyrjet për parandalimin e përshkallëzimit në kriminalitet të mirëfilltë. Pjesa më e madhe e profesionistëve janë të mendimit se prezenca e një faktori të vetëm risku nuk mund të çojë në delinkuencë. Për këtë arsye është e nevojshme të operohet në disa nivele, siç janë:¹⁰²

- individ;
- familja;
- grupi i bashkëmoshatarëve;
- zona e banimit (lagjia);
- shkolla.

Edhe pse disa nga faktorët e riskut janë të njëjta për një pjesë të mirë të të miturve në konflikt me ligjin, tiparet dhe kombinimi i këtyre faktorëve variojnë rast pas rasti. Pjesa më e madhe e profesionistëve janë të mendimit se ndërsa në fëmijërinë e hershme risku më i lartë vjen

¹⁰² Child Delinquency, Bulletin Series, U.S Department of Justice, Office of Justice Programs, Office of Juvenile Justice and Delinquency Prevention, 2003, fq. 25.

nga faktorët individualë, (si p.sh. komplikacione në lindje, hiperaktivitet, temperament i vështirë etj.) dhe faktorë familjarë (p.sh. sjellje prindërore antisociale apo kriminale, abuzim me substancat, neglizhencë etj.) ndërsa fëmija rritet dhe integrohet në shoqëri, fillojnë të luajnë një rol shumë të rëndësishëm faktorët e rinj të riskut që lidhen me influencën e bashkëmoshatarëve, me shkollën dhe komunitetin.¹⁰³

Pavarësisht rëndësisë që ka fokusimi në faktorët e riskut, analizimi i faktorëve mbrojtës që ndikojnë në reduktimin e delinkuencës është po aq i rëndësishëm për ndërtimin e strategjive efikase të ndërhyrjes. Disa faktorë mbrojtës mund të jenë:

- sjellja prosociale: shfaqja e empatisë gjatë viteve të para të shkollës;
- gjinia: femrat shfaqin sjellje kriminale më pak sesa meshkujt;
- performancë e mirë kognitive: zhvillim i mirë gjuhësor dhe performancë e mirë akademike.¹⁰⁴

2. Faktorët individualë të paraqitjes së delikuencës së të miturve

Sjellja e të miturve është rezultat i faktorëve gjenetikë, socialë dhe të mjedisit. Më poshtë janë rradhitur disa nga këta faktorë:

Sjellja antisociale. - Sjellja e hershme antisociale mund të jetë parashikuesi më i saktë i shfaqjes së delinkuencës më vonë gjatë jetës. Përgjithësisht sjellja antisociale përfshin forma të ndryshme të thyerjes së rregullave dhe të agresionit, të tilla si vjedhjet, sulmet fizike dhe vandalizmi. Në fakt agresioni i hershëm duket se është një nga sjelljet sociale më doemethënëse që parashikon sjelljen delinkuente përpara moshës 13 vjeç. Sipas një studimi të kryer në kopshte, agresioni fizik në këtë moshë, rezultoi të ishte një parashikues i mirë i përfshirjes së mëvonshme të të miturve në krimet ndaj pronës. Në të kundërtën, sjellja prosociale (e tillë si dhënia e ndihmës dhe bashkëpunimi) dukej se ishte një nga faktorët mbrojtës, sidomos për fëmijët që

¹⁰³ Po aty.

¹⁰⁴ Child Delinquency, Bulletin Series, U.S Department of Justice, Office of Justice Programs, Office of Juvenile Justice and Delinquency Prevention, 2003, fq. 25.

konsideroheshin të riskuar për kryerjen e krimeve të dhunshme apo krimeve ndaj pronës përpara moshës 13 vjeç.¹⁰⁵

Mendohet se sjellja antisociale është parashikuesi më i mirë i moshës së arrestit të parë. Gjithashtu mendohet se fëmijët që janë arrestuar para moshës 13 vjeç, kanë më shumë gjasa të kthehen në recidivistë deri në moshën 18 vjeç.¹⁰⁶ Të tjera studime konfirmojnë se parashikuesi më i mirë i sjelljes antisociale të mëvonshme ishte rehatimi i nënave për vështirësi në lidhje me menaxhimin e fëmijëve të tyre në moshën 3 vjeç dhe rehatimi i të dy prindërve për probleme të sjelljes së fëmijëve të tyre në moshën 5 vjeç.¹⁰⁷

Gjithësesi, nga studimet e kryera në këtë fushë rezulton se ndërsa pjesa më e madhe e fëmijëve që konsiderohen të vështirë për tu menaxhuar në moshën 3 vjeç nuk bëhen delinkuentë përpara moshës 13 vjeç, pjesa më e madhe e fëmijëve që bëhen të tillë përpara kësaj moshe, shfaqin probleme të sjelljes që në vitet e para të jetës. Këto studime hedhin dritë mbi rëndësinë e viteve të para të jetës, në shfaqjen e sjelljeve kriminale më vonë gjatë jetës duke vënë theksin në rëndësinë dhe ndikimin e faktorëve individualë të riskut.

Faktorët emocionalë. - Studiuesit janë të mendimit se në fund të vitit të tretë të jetës, fëmijët janë në gjëndje të shprehin të gjitha llojet e emocioneve njerëzore, përfshirë këtu zemërimin, krenarinë, turpin dhe fajin. Prindërit, edukatorët, por dhe bashkëmoshatarët, influencojnë në mënyrën sesi fëmijët shprehin emocionet dhe i ndihmojnë ata të mësojnë ti menaxhojnë ato në mënyrë konstruktive. Mënyra sesi fëmijët mësojnë të shprehin emocionet që në fëmijërinë e hershme (sidomos zemërimin), mund të ndikojë në rritjen apo reduktimin e riskut të delinkuencës.

Disa studime për delinkuencën janë fokusuar në koncepte si frenimi (inhibimi) dhe aktivizimi i sjelljes. Inhibimi i sjelljes në përgjigje të stimujve të rinj, apo të ndëshkimeve, përfshinë frikën, ankthin dhe ndrojtjen. Aktivizimi i sjelljes përfshinë impulsivitetin, hiperaktivitetin dhe agresivitetin. Ka të dhëna se nivele të larta të aktivizimit të sjelljes dhe nivele

¹⁰⁵ Haapasalo, J., and Tramblay, R.E., "Physically aggressive boys from age 6 to 12: Family background, parenting behavior and prediction of delinquency". Journal of Consulting and Clinical Psychology, 1994, 74.

¹⁰⁶ Patterson, G.R., Crosby, L., and Vulchinich, S. "Predicting risk for early police arrest. Journal of Quantitative Criminology", 1992, fq. 59.

¹⁰⁷ White, J.L., Moffitt, T.E., Earls, F., Robins, L., and Silva P.A., "How early can we tell? Predictors of childhood conduct disorder and delinquency. Criminology, 1990, fq. 105.

të ulëta të inhibimit të saj përbëjnë faktorë risku për shfaqjen e sjelljeve antisociale.¹⁰⁸ Përgjithësisht studimet kanë treguar se djemtë impulsivë dhe jo ankthiozë kanë më shumë gjasa për të kryer akte delinkuente rreth moshës 12-13 vjeç. Megjithatë, studiuesit nuk e kanë përcaktuar nëse karakteristikat emocionale në fëmijëri përbëjnë faktorë risku, apo thjesht korrelojnë me shfaqjen e mëvonshme të sjelljes antisociale.

Zhvillimi kognitiv. - Zhvillimi i varfër kognitiv dhe problemet e sjelljes gjatë fëmijërisë së hershme mund të shpjegojnë lidhjen që ekziston mes arritjeve akademike dhe delinkuencës. Disa studime kanë treguar se inteligjenca verbale e delinkuentëve është më e ulët sesa ajo joverbale. Delinkuentët gjithashtu kanë arritje më të ulëta akademike sesa jodelinkuentët.¹⁰⁹ Deficitet neuropsikologjike prezente në lindje mund të ndikojnë në shfaqjen e problemeve të sjelljes, duke qënë se ndikojnë në temperamentin e fëmijës. Këto deficite mund të prekin kontrollin mbi të folurin, vëmendjen, agresivitetin dhe hiperaktivitetin.¹¹⁰

Hiperaktiviteti. - Studimet klinike për fëmijët hiperaktivë kanë sjellë fakte se këta fëmijë kanë risk të lartë për kryerjen e akteve delinkuente më vonë.¹¹¹ Për shembull, hiperaktiviteti motor i fëmijëve të kopshteve rezultoi parashikues i mirë për sjelljet delinkuente të mëvonshme, krahasuar me mungesën e sjelljes prosociale dhe ankthit.¹¹²

Faktorët familjarë të riskut. - Disa nga faktorët kryerësorë të riskut për sjellje delinkuente të miturve janë ato që derivojnë nga familja si p.sh., stili i prindërimit, keqtrajtimi i fëmijëve, dhuna në familje, divorci i prindërve, psikopatologjitë e prindërve, historia familjare e sjelljeve antisociale, të qenit fëmijë i prindërve adoleshentë, struktura e familjes dhe numeroziteti i saj.

Stili i prindërimit. - Praktikrat e papërshtatshme të prindërimit janë ndër shkaqet dhe parashikuesit më të fuqishëm të delinkuencës.¹¹³ Krahasuar me familjet me fëmijë që nuk shfaqin

¹⁰⁸ Farrington, D.P., "Predictors, causes and correlates of male youth violence", In youth violence, vol.24, edited by M. Tonry and M.H. Moore. Chicago I.L: University of Chicago Press, 1998, fq. 76.

¹⁰⁹ Fergusson, D.M., and Horwood, L.J., "Early disruptive behavior IQ, and later school achievement and delinquent behavior" Journal of Abnormal Child Psychology, 1995, fq. 124.

¹¹⁰ Moffitt, T.E., "The neuropsychology of conduct disorder" Development and psychopathology, 1993, fq. 59.

¹¹¹ Loeber, R., Green, S.M., Keenan, K., and Lahey, B.B., "Which boys will fare worse? Early predictors of the onset of conduct disorder in a six year longitudinal study" Journal of American Academy of Child and Adolescent Psychiatry, 1995, fq. 129.

¹¹² Tremblay, R.E., Pihl, R.O., Vitaro, F., and Dobkin, P.L., "Predicting early onset of male antisocial behavior from preschool behavior". Archive of General Psychiatry, 1994, fq. 259.

¹¹³ Hawkins, J.D., Herrenkohl, T., Farrington, D.P., Breëer, D., Catalano, R.F., and Harachi, T.W. "A review of predictors of youth violence in serious and Violent Juvenile Offenders" Risk Factors and Successful Interventions, Edited by R. Loeber and D.P Farrington. Thousand Oaks, C.A: Sage Publications, Inc., 1998, fq. 76.

probleme të sjelljes, në familjet me fëmijë që shfaqin problem të kësaj natyre, mendohet se në mënyrë të paqëllimshme përforcohet sjellja negative e fëmijëve.¹¹⁴

Sipas Wasserman, rezulton se tri janë praktikat e prindërimit të lidhura veçanërisht me problemet e sjelljes:

- konfliktet e shpeshta mes prindërve dhe fëmijëve;
- mungesa e kujdesit të prindërve ndaj fëmijëve;
- niveli i ulët i përfshirjes.¹¹⁵

Keqtrajtimit. - Keqtrajtimi, apo abuzimi me fëmijët, zakonisht bashkëshoqërohet me faktorë të tjerë familjarë risku dhe me kryerjen e akteve delinkuente në moshë të re. Duke u fokusuar sidomos në marrëdhënien midis abuzimit fizik dhe agresivitetit që shfaqin të miturit, një studim i kryer në këtë kontekst sugjeron se 20% e fëmijëve të abuzuar bëhen delinkuentë përpara moshës adulte.¹¹⁶

Duhet sqaruar se një pjesë e mirë e fëmijëve të abuzuar fizikisht nuk bëhen antisocialë apo të dhunshëm. Sidoqoftë një studim që krahason fëmijët pa histori abuzimi apo neglizhimi, me fëmijë të abuzuar apo të neglizhuar, zbuloi se këta të fundit kanë qënë më shumë subjekt arrestimesh deri në moshën 25 vjeç.¹¹⁷

Dhuna në familje. - Të qenit dëshmitarë të dhunës në familje ndikon në rritjen e problemeve të sjelljes sidomos te fëmijët meshkuj.¹¹⁸ Po ashtu sipas studimeve të kryera në këtë fushë rezulton se në shumë familje ku ushtrohet dhunë ndaj nënave, ushtrohet dhunë njëkohësisht dhe ndaj fëmijëve.¹¹⁹ Të qenit i abuzuar, apo dëshmitar i dhunës në familje mendohet se prek sjelljen e të miturve dy herë më shumë sesa të qenit vetëm dëshmitar i dhunës.¹²⁰ Një tjetër faktor që e rrit riskun në familjet e dhunshme, përfshin incidencën e lartë të problemeve të tjera të sjelljes, si

¹¹⁴ Gardner, F.E.M., "Positive interaction between mothers and conduct-problem children: Is there training for harmony as well as fighting?", *Journal of Abnormal Child Psychology*, 1987, fq. 91.

¹¹⁵ Wasserman, G.A., Miller, L., Pinner, E., and Jaramillo, B.S., "Parenting predictors of early conduct problems in urban, high-risk boys." *Journal of American Academy of Child and Adolescent Psychiatry*, 1996, fq. 49.

¹¹⁶ Lewis, D.O., Mallouh, C., and Webb, J., "Child abuse, delinquency, and violent criminality". *Theory and research on the Causes and Consequences of Child Abuse and Neglect*, edited by D.Cicchetti and V.Carlson, New York, Cambridge University Press, 1989, fq. 159.

¹¹⁷ Widom, C.S., "The cycle of violence Science", 1989, fq. 47.

¹¹⁸ Reid, W.J., and Crisafulli, A., "Marital discord and child behavior problems: A meta analysis", *Journal of Abnormal Child Psychology*, 1990, fq. 68.

¹¹⁹ McKibben, L., De Vos, E., and New Berger, E., "Victimization of mothers of abused children: A controlled study", 1989, fq. 96.

¹²⁰ Hughes H.M., Parkinson, D., and Vargo, M., "Witnessing spouse abuse and experiencing physical abuse", *Journal of Family Violence*, 1989, fq. 158.

abuzimi me alkoolin dhe burgimi. Distresi psikologjik i nënave në mënyrë indirekte është gjithashtu një faktor që ekspozon fëmijën ndaj një risku më të lartë, duke qenë se këto nëna janë të padisponueshme emocionalisht për tu kujdesur për ta.¹²¹

Divorci i prindërve. - Krahasuar me djemtë prindërit e të cilëve kanë qëndruar të martuar, djemtë me prindër të divorcuar mendohet se shfaqin më shumë probleme të sjelljes antisocial dhe jokompliante rreth moshës 10 vjeç.¹²² Sidoqoftë, duke marrë parasysh faktorët e shumtë që lidhen me funksionimin apo mosfunksionimin e familjes, është e vështirë të nxirren konkluzione të sakta mbi efektin real që ka divorci i prindërve në sjelljen e mëvonshme të fëmijëve.

Psikopatologjitë e prindërve. - Sipas rezultateve të një studimi të kryer, rreth 45% e prindërve të djemve të mitur me probleme të sjelljes, vuajnë nga çrregullimi antisocial i personalitetit. Nivele të njëjta janë raportuar për abuzimin me substancat dhe depresionin.¹²³ Prindërit depresivë shfaqin shumë deficite përsa i përket rolit që u duhet të luajnë në jetën e fëmijës, gjë që shoqërohet me nivele të larta të shfaqjes së sjelljeve antisociale te fëmijët. Po ashtu psikopatologjitë nga të cilat mund të jenë të prekur prindërit lidhen me nivele të larta të shfaqjes së çrregullimeve psikiatrike te fëmijët.¹²⁴

Sjelljet antisociale brenda familjes. - Një histori e gjatë kërkimesh tregon se sjellja agresive dhe kriminaliteti kanë prevalencë më të lartë në disa familje sesa në disa të tjera. Adultët antisocial preferojnë të zgjedhin partnerë po antisocialë.¹²⁵ Po ashtu, rezulton se prindërit antisocialë krijojnë më shumë konflikte brenda familjes, tentojnë ti mbikqyrin më pak fëmijët dhe sillen më ashpër me ta. Për më tepër të pasurit e një vëllai me personalitet antisocial mendohet se rrit gjasat për shfaqjen e sjelljeve antisociale. Mendohet se influenza e vëllezërve në këtë aspekt është më e madhe kur fëmijët kanë pak diferencë moshe midis tyre.¹²⁶

¹²¹ Zuckerman, B., Augustyn, M., Groves, B.M., and Parker, S., "Silent victim revisited: the special case of domestic violence", 1995, fq. 195.

¹²² Hetherington, E.M., "Coping with family transitions: Winners, losers and survivors. Child Development", 1989, fq. 98.

¹²³ Lahey, B.B., Piacentini, J.C., Mc Burnett, K., Stone, P., Hartdagen, S., and Hynd, G., "Psychopathology in the parents of children with conduct disorder and hyperactivity", Journal of the American Academy of Child and Adolescent Psychiatry, 1988, fq. 58.

¹²⁴ Costello, E.J., Farmer, E.M., Angold, A. Burns, B., and Erkanli, A., "Psychiatric disorders among American Indian and White youth in Appalachia: The great Smoky Mountains Study". American Journal of Public Health, 1997, fq. 97.

¹²⁵ Farrington, D.P., Barnes, G.C., and Lambert, S., "The concentration of offending in families". Legal and Criminological Psychology, 1996, fq. 129.

¹²⁶ Farrington, D.P., "The development of offending and antisocial behavior from childhood: Key findings from the Cambridge Study in Delinquent Development." Journal of Child Psychology and Psychiatry, 1995, fq. 95.

Të qënurit fëmijë i prindërve adoleshente. - Fëmijët e nënave adoleshente kanë më shumë gjasa për të kryer akte kriminale në adoleshencë.¹²⁷ Sa më sipër mund të ketë lidhje me personalitetin antisocial të nënës, apo dhe me lidhjet e saj me partnerë antisocialë.¹²⁸

Struktura e familjes. - Shumë nëna të vetme (në mungesë të një partneri), janë të afta t'i rrisin fëmijët në mënyrë të përshtatshme. Sidoqoftë, studimet tregojnë se fëmijët e rritur nga nëna të vetme shtëpiake janë më të rrezikuar për të shfaqur probleme të sjelljes.¹²⁹ Kjo gjë është e lidhur dhe me faktin që këto nëna zakonisht kanë më pak burime për të siguruar të ardhurat e familjes. Të tjerë faktorë po ashtu mund të shpjegojnë këtë korrelacion. Krahësuar me nënat që kanë një partner, nënat e vetme raportojnë më shumë probleme të shëndetit mendor. Këto probleme ndikojnë drejtpërdrejt në mënyrën sesi ato kudesen për fëmijët e tyre.¹³⁰

Po ashtu, këto nëna mund të ndryshojnë shpesh vendbanim dhe kanë më pak mundësi për të monitoruar aktivitetet në të cilat përfshihen fëmijët e tyre.¹³¹ Si përfundim, mund të dalim në një konkluzion të përgjithshëm se secili nga faktorët e lartpërmendur mund të kontribuojnë në rritjen e gjasave për sjelljen problematike të fëmijëve. Zakonisht këta faktorë gjenden të kombinuar me njëri-tjetrin, kështu që është e vështirë të përcaktohet masa e ndikimit të secilit prej tyre në përfshirjen e të miturve në aktivitete të jashtëligjshme.

Familjet e mëdha. - Sa më shumë fëmijë të jenë në familje, aq më i lartë është rreziku për delinkuencë. Nga një studim i Cambridge rezultoi se krahasuar me djemtë që kishin më pak motra e vëllezër, djemtë të cilët kishin katër apo më shumë të tillë rreth moshës 10 vjeçare ishin dy herë më të rrezikuar për të shfaqur sjellje antisociale pavarësisht nga statusi socio-ekonomik i familjes.¹³² Këto rezultate mund të lidhen me mundësitë më të pakta të prindërve me shumë fëmijë për ti monitoruar ata, apo dhe me mundësitë më të pakta ekonomike për t'u ofruar fëmijëve supervision të përshtatshëm dhe mbështetje ekonomike.

¹²⁷ Conseur, A., Rivara, F.O., Barnowsky, R., and Emmanuel, I., "Maternal and perinatal risk factors for later delinquency", 1997, fq. 91.

¹²⁸ Rutter, M., Giller, H., and Hagell, A., "Antisocial Behavior by Young People", New York, Cambridge University Press, 1998, fq. 168.

¹²⁹ Pearson, J.L., Ialongo, H.S., Hunter, A.G., and Kellum, S.G., "Family Structure and Aggressive behavior in a population of urban elementary school children", Journal of the American Academy of Child and Adolescent Psychiatry, 1994, fq. 195.

¹³⁰ Guttentag, M., Salasin, S., and Belle, D., "The mental Health of Women", New York, Academic Press, 1980, fq. 63.

¹³¹ McLanahan, S., and Booth, K., "Mother-only families: Problems, prospects and politics", Journal of Marriage and Family, 1989, fq. 147.

¹³² West, D.J., and Farrington, D.P., "Who became delinquent?", London, England, 1973, fq. 96.

Refuzimi nga bashkëmoshatarët. - Të dhënat që tregojnë se refuzimi nga bashkëmoshatarët është një faktor risku për sjelljet antisociale, janë relativisht të reja krahasuar me të dhënat për influencën që kanë bashkëmoshatarët në këtë kontekst. Kërkimet e fundit kanë treguar se të miturit e refuzuar nga bashkëmoshatarët janë shumë herë më të rrezikuar për të shfaqur sjellje antisociale në mënyrë të përsëritur në të ardhmen, krahasuar me fëmijët që nuk kanë qenë të refuzuar.¹³³

Mjedisi-ambienti social si faktor që ndikon në sjelljet delikuate të të miturve. - Pothuajse çdo ditë lexojmë dhe dëgjojmë nga mjetet e ndryshme të informimit për grupe të ndryshme delikuate, të cilat kanë kryer veprime delikuate në lagje kafiteri apo vende të ndryshme publike. Duke pasur parasysh faktin që të miturit konsiderohen fëmijët prej moshës 14 deri në moshën 18 vjeçare dhe në këtë moshë fëmijët e kalojnë kohën më të madhe me shoqërinë në mjedisin jashtë familjes pas shkollës si faktor që ndikon në paraqitjen e sjelljeve kriminale e kemi paraqitur edhe mjedisin shoqëror duke kontaktuar me moshatarë, por edhe njerëz të moshave të ndryshme. Në jetën e përditshme, sidomos në qendrat e mëdha urbane dhe industrial, në disa lagje dhe kuarte, njerëzit, familjet e sidomos të rinjtë vijnë në situatë të kontaktojnë dhe të kenë raporte të ndryshme me persona dhe grupe të llojllojshme. Këto grupe dhe individë, shpeshherë janë të prirur për sjellje sociale, devijante dhe kriminale.¹³⁴

Pra, çdo njeri, prandaj edhe të miturit, jetojnë në një mjedis të caktuar shoqëror, i cili ka mënyrat e veta të jetës, shprehjet e veta dhe cilësitë e pjestarëve të tij. Fëmija është vetëm pjestarë, përfaqësues i atij grupi etnik dhe ekonomik dhe i atij mjedisi, i cili ia përshkon tërë jetën, planet e të tjera.¹³⁵ Fëmija për shkak të zhvillimit të tyre psikofizik në këtë moshë shumë lehtë ndikohen nga njerëzit përreth dhe këta të fundit e shfrytëzojnë rastin duke i bërë edhe shantazhe për t'i kyqur në grup dhe kështu këta të rinjë bëhen delikuentë duke bashkpunuar në veprime të ndryshme delikuate nga ato të shpeshta janë vjedhjet, siç i hasim edhe në shëimet statistikore të Gjykatave. Ndikimi i faktorit mjedis-ambient social në Regjionin e Pejës ka bërë që disa të rinjë kanë reflektuar sjellje delikuate dhe kanë rënë pre e shoqërisë për të kryer vepra penale, një ndër rastet e shumta që kam hasur gjatë hulumtimit të këtij punimi do ta paraqes në vijim.

¹³³ Child Delinquency, Bulletin Series, U.S Department of Justice, Office of Justice Programs, Office of Juvenile Justice and Delinquency Prevention, 2003, fq. 53.

¹³⁴ Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2011, fq. 286.

¹³⁵ Vesel Latifi, Kriminalistikat e delikuencës së të miturve, Prishtinë, 1982, fq. 81.

Shembull: I mituri A.B është dënuar nga Gjykata e Qarkut në Pejë për veprën penale Vjedhje e rëndë nga neni 253 par. 1, pika 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së, veprën penale ka kryer në bashkëveprim me shokun e tij. Gjatë shqyrtimit gjyqësor në fjalën përfundimtare të përfaqësueses ligjore-nënës së të miturit mësojmë se ky i mitur ishte djalë i qet deri sa u shoqërua me shokët e tij që ishin akuzuar për vepra të njëjta penale. Nga shiqimi në shkresat e lëndës, anketat sociale dhe raportet përfundimtare të punuara nga zyrtarët e SHSK-së mund të themi që mjedisi-ambienti social ka ndikim tek të miturit në kycjen e rrethit jot ë mirë shoqëror duke pasur parasysh moshën dhe zhvillimin psikofizik të tyre.¹³⁶

3. Faktorët ekonomiko-socialë

Kushtet ekonomike të jetesës së të miturve luajn një rol të rëndësishëm dhe kryerësor në jetën e tyre dhe llogariten ndër faktorët kryerësor në edukimin dhe zhvillimin e tyre. Krizat dhe depresionet ekonomike trajtohen si faktorë që kanë ndikim të dukshëm në sjelljet kriminale. Rezultatet e kërkimeve dhe studimeve empirike të raporteve në mes krizave ekonomike dhe kriminalitetit tregojnë se, në disa raste këto rrethana ndikojnë dukshëm në shtimin e disa formave të kriminalitetit si: vjedhjet, mashtrimet, abuzimet, tregtia e ndaluar, prostitucioni, etj.¹³⁷

Edhe kushtet e luftës kanë ndikim në paraqitjen e disa formave të kriminalitetit. Ndikimi i tillë mund të reflektohet në forma të ndryshme, në varshmëri nga ajo se a bëhet fjalë, për periudhën afër luftës, perudhën në luftë dhe në periudhën pas luftës. Gjatë kohës së luftës shumë fabrika i zvoglojnë prodhimet e veta ose fare nuk prodhojnë, dhe në këtë mënyrë fillon mungesa e të mirave material. Në këtë kohë i jepet shans berzës së sezë, dhe shumë matrapazëve të ndryshëm që në rend të parë i rrisin çmimet. Psikoza e luftës gjithashtu sjell harxhimin e mjeteve material. Shumë familje nën mesatare, në vrap që të sigurojnë artikuj të domosdoshëm ushqimor, i harxhojnë edhe ato pak mjete material që i kanë. Faza e pasluftës sjell deri te humbja e shumë

¹³⁶ Aktygjykim PM NR. 278/09 Gjykata e Qarkut në Pejë.

¹³⁷ Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2016, fq. 246.

personave që kanë rënë në luftë, veçanërisht meshkujt. Kështu, paraqiten edhe familje të tjera deficitare dhe me këtë rast kushtet e volitshme për paraqitjen e delikuencës së të miturve.¹³⁸

Ndikimi i varfërisë në delikuencën e të miturve. - Bota bashkëkohore cilësohet me kontradikta të mëdhaja, në njërën anë ka transformime dhe të arritura, vende të pasura dhe me standard të larta, ndërsa në anën tjetër ka shtete dhe regjione shumë të varfëra ku popullsia nuk ka mundësi të sigurojë as nevojat më elementare për ekzistencë, për ushqim, për veshmbathje apo kulm mbi kokë.¹³⁹ Sipas të dhënave të Bankës Botërore për ndihma dhe Institutit ndërkombëtar për kërkimin e politikës së ushqimit del se 1/5 e banorëve të rruzullit tokësor, jeton me një dollar në ditë.¹⁴⁰ Varfëria dhe skamja mund të ndikojnë në sjelljet dhe qëndrimet e disa të miturve, sidomos në sjelljet e atyre që edhe ashtu janë labil, dhe të zhytur në veprime dhe sjellje kriminale.¹⁴¹ Sipas Dr. Milan Milutinoviç, si faktorë që ndikojnë në varfëri janë: kushtet e rënda material, kushte që shkaktojnë shpeshherë demoralizime dhe dëshprime për jetë të të miturit, të cilët të paafte që të përballen me këto kushte, shpesh here jepen pas sjelljeve delikuede.¹⁴² Hulumtimet kriminologjike të bëra në vende të ndryshme të botës, vërtetojnë se numri më i madh i delikuentëve të mitur rrjedh prej familjeve dhe grupeve sociale që kanë problem dhe vështirësi materiale.¹⁴³

Ndikimi i papunësisë në delikuencën e të miturve. - Papunësia është e ngjashme me dukurinë e varfërisë dhe ka të bëjë me pamundësimin e kyçjes në punë të njerëzve e, kjo sjell mungesën e mjeteve për ekzistencë. Kriminologu i njohur francez Konstant, papunësinë dhe problemet të cilat krijohen tek individët dhe familjet, i konsideron si faktorë dhe rrethanë që i paraprinë krimit në shoqëri. Papunësia edhe problemet që ndërlidhën me ta, veçmas ndikojnë në paraqitjen e delikuencës së të miturve dhe kriminalitetit të të rinjve.¹⁴⁴

Ekzistojnë shumë faktorë prej të cilëve varet se çfarë vetishë do të dominojnë tek i mituri në një shoqëri. Përveç tjerash, ato varen edhe prej kushteve ekonomike, të cilat më së shumti ndikojnë në shoqërinë e caktuar dhe, në mënyrë të fuqishme pasqyrohen në zhvillimin e personalitetit të të miturit. Papunësia si dukuri dhe problem social, veçmas vjen në shprehje gjatë krizave ekonomike, luftrave, si dhe tranzicionit ku shumë fabrika dhe ndërmarrje mbyllen dhe në

¹³⁸ Z. Sulejmanov, Makedonska Kriminologjia, Shkup, 2000, fq. 626.

¹³⁹ Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2011, fq. 248.

¹⁴⁰ Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2011, fq. 248.

¹⁴¹ Ismail Zejneli, Delikuenca e të miturve, Tetovë/ Prishtinë, 2018, fq. 128.

¹⁴² Po aty, fq. 129.

¹⁴³ Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2011, fq. 248.

¹⁴⁴ Po aty.

këtë mënyrë shumë njerëz hidhen në rrugë si të papunë. Për shkak të pamundësisë së plotësimit të nevojave elementare për jetesë të anëtarëve të familjeve të tyre si shkak i papunësisë së prindërve shumë të mitur jepen pas sjelljeve të ndryshme kriminale dhe të përballur para një situatë të këtillë shumë të mitur shkollën e lënë në plan të dytë, kurse duke dashur të përfitojnë diç materialisht, futën edhe në biznese të pista, në fillim si ndihmës të vegjel e më pas si kryerës dhe shumë prej tyre bëhen edhe profesionista.¹⁴⁵ Gjendja e papunësisë shkakton një apati dhe zhgënjim i cili lidhet me pa prespektivën e zgjidhjes së problemeve të cilat krijohen në familje dhe të individit. Shpeshherë disa individë dhe grupe duke dashur që të dalin nga kjo gjendje e vështirë, fillojnë të merren me disa aktivitete dhe veprime të dëmshme sociale, psh., me prostitucion, bledhje, lëmoshë, braktisje të familjeve dhe të fëmijëve.¹⁴⁶

Ndikimi i migrimit të popullsisë në delikuencën e të miturve. - Migrimi i popullsisë fshat-qytet është përcjellë me ndryshime të mëdha, para se gjithash gjatë përpjekjeve që të arrihet standardi jetësor, i kushteve të jetës së qytetit për shkak të ndërprerjes së shpejtë të lidhjeve jetësore me fqinjët, miqtë dhe lidhjet tjera, si dhe heqja dorë nga ambient fshatar dhe mënyra e jetesës, shpeshherë nuk janë në gjendje që t'u adaptohen kushteve të reja të jetës, sidomos nuk janë në gjendje që të ndjekin dhe të bashkëveprojnë me ecuritë e reja kulturore, politike, ekonomike, dhe të tjera, si pasojë e gjithë këtyre, paraqitet depresioni emocional dhe urrejtja.¹⁴⁷

Migrimet paraqesin lëvizjen e popullsisë nga një territor në territorin tjetër. Në literaturë përmenden disa lloje të migrimeve si: migrimet kohore, sezonale, ditore, migrimet brenda shtetit dhe migrimet në botën e jashtme. Migrimi i shpejtuar i banorëve nga fshati në qytet dhe pamundësia e punësimit të sinkronizuar të popullsisë së migruar për shkak të kapaciteteve të pamjaftueshme të vendeve të punës në prodhim dhe fuqisë së pakualifikuar puntore, krijojnë problem të shumta sociale, kulturore dhe edukative.¹⁴⁸

Trendi i lëvizjes së popullsisë së re nga mjedisi rural në mjedisin urban, dhe nga qendrat industrial, bëhet për më shumë arsye, duke filluar prej atyre ekonomike dhe deri tek ato shoqërore. Mirëpo, jo të gjithë të miturit i përshtaten këtij trendi apo mënyrës së jetesës në qytet, disa prej tyre shumë rëndë adaptohen në këto mjedise, dhe si rezultat i mosgjetyes së mbështetjes

¹⁴⁵ Ismail Zejneli, Delikuenca e të miturve, Tetovë/ Prishtinë, 2018, fq. 131.

¹⁴⁶ Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2011, fq. 231.

¹⁴⁷ Vesel Latifi, Ragip Halili, Kriminaliteti i të rinjëve në Kosovë, Prishtinë, 1997, fq. 244-246.

¹⁴⁸ Vesel Latifi, Kriminalistika e delikuencës së të miturve, Prishtinë, 1982, fq. 36.

së rrethit dhe braktisjes së mjedisit të mëparshëm dhe shoqërinë e mëparshme, fillojnë ta braktisin shkollën e më pas edhe lehtë fillojnë të jepen pas sjelljeve të ndryshme delikuede.¹⁴⁹

4. Ndikimi i mjeteve të komunikimit masiv dhe delikueda e të miturve

Ndikimi i shtypit të përditshëm ndaj të miturve. - Shtypi i përditshëm, ai revial, gazetatat e ilustruara dhe zbavitëse shpeshherë, me informata të tilla senzacionale, me fotografi dhe ilustrime të rasteve kriminale, sidomos me paraqitjen e përshkrimeve në detaje të rasteve, ngjarjeve, biografive të personaliteteve të ndryshme, sidomos atyre problematike, nga bota e filmit, nga bota edhe e rok muzikës, të një kategori e të miturve nxisin dhe shtytin veprimtari kriminale.¹⁵⁰ Gjithashtu, prezantimi selektiv, senzacional, dramatik, paraqitja e skenave të tmerrshme të vrasjeve, përleshjeve, plaçkitjeve, dhunimeve të një kategorie të njerëzve, sidomos të të rinjve, nxisin motive të ulëta, emocione dhe epshe të shfrenuara, psikozë të frikës dhe pasigurisë.¹⁵¹ Sot një numër i madh i gazetave të ilustruara, revistave zbavitëse, sidomos atyre me përmbajtje pornografike, videolojërat, internet të cilat gjoja u ofrojnë të miturve mundësi për argëtim dhe për kalim të kohës së lirë, e kanë edhe tirazhin më të madh. Përmbajtjet e tilla, shpeshherë nuk janë në përputhje me moralin e shëndoshë familjar e shoqëror, prandaj në këto raste flitet për efekte dhe ndikime negative të këtyre mjeteve të komunikimit masiv.¹⁵² Prof. dr. Ragip Halili thekson se me gjithë rolin e madh të mjeteve të komunikimit masiv në edukimin e të miturve, paraqitja e shkrimeve, emisioneve, filmave dhe përmbajtjeve tjera të cilat kanë vlera të dyshimta morale, kontribuojnë dukshëm në nxitjen e sjelljeve delikuede dhe kriminale.

Ndikimi i televizionit në delikuedën e të miturve. - Televizioni me programet e veta shikohet edhe nga të miturit, duke iu ofruar atyre ngjarje të ndryshme qofshin ato aktuale, sportive, filma të ndryshëm me përmbajtje ku prezantohet dhuna, programe ku flitet për prostitucionin, drogën e kështu me radhë. Në këto kushte kur në programet televizive arrijnë dhjetra kanale të ndryshme, qindra kanale satelitore si dhe nga rrjeti kablovik, mundësia për përcjelljen e thukët të programeve është e vogël. Shikuesit humben në vështirimin e ofertave, dhe

¹⁴⁹ Ismail Zejneli, Delikueda e të miturve, Tetovë/ Prishtinë, 2018, fq. 132.

¹⁵⁰ Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2011, fq. 264.

¹⁵¹ Po aty.

¹⁵² Po aty.

për këtë arsye vështirësohet përcjellja dhe selektimi i programeve të cilat ndikojnë te shikuesit e moshës së mitur. Këtu edhe paraqitet konflikti te prindërit të cilët për vete duan një program më të pasur dhe të lojlojshëm, ndërsa për fëmijët e tyre selektojnë vetëm një pjesë nga to.¹⁵³ Ajo që na iriton është se shumica e mediumeve përqëndrohen dhe garojnë në mes tyre me materialin propagandues të linjave të nxehta. Nuk përjashtohet edhe fakti se nëpër programet të cilat janë të “zgjedhura” për shikuesit, qofshin aktuale ose muzikore, paraqitjet skenike të këngëtarëve prezantojnë haptas moralin e tyre. Programet televizive me përmbajtjet e tyre janë të pranishme ten një auditorium mjaft i gjerë dhe sipas disa karakteristikave të veçanta të televizionit, ato kanë ndikim të madh, sidomos te të rinjtë.¹⁵⁴

Ndikimi i filmit në delikuencën e të miturve. - Filmi si mjet i kulturës masive, për jetën e të miturit, ka një rol shumë të madh dhe zë vend të rëndësishëm. Filmat me përmbajtje edukuese, padyshim se janë të mirëpritur nga të gjithë, ndërsa filmat me përmbajtje negative në njërën apo formën tjetër tek disa të mitur ndikojnë që ndonjë faktor latent të kalojë në formë të hapur manifestuese. Tek ne por, edhe më gjerë, është i madh numri i shembujve, që përmbajtja e disa filmave ndikon negativisht edhe në kryerjen e veprimeve të ndryshme delikuede nga ana e të miturve. Menjëherë pas shfaqjes së filmit, me përmbajtje vjedhjeje disa të mitur duke dashur që ti imitojnë aktorët e filmit të shikuar në rrethin ku jetojnë, kanë kryer vjedhje të rënda.¹⁵⁵ Ndjekja e filmave me përmbajtje provokuese tek të miturit ndikon dëmshëm. Porosityë që dërgohen përmes këtyre videoklipeve, video lojrave tek të miturit lënë gjurmë të rënda, ndoshta edhe me pasoja të paparashikuara. Mundësia që disa here të përcillën këto skena sjell deri te varshmëria për to, të cilat në fillim këto përmbajtje i përcjellin nga kureshtja ndërsa më vonë bëhen të varur nga to. Fatkeqësisht videoklipet me përmbajtje erotike por edhe me përmbajtje pornografike gjenden edhe tek të miturit e shkollave të mesme, por bile edhe tek filloristët.¹⁵⁶

Ndikimi i internetit në delikuencën e të miturve. - Interneti sot në botë paraqet mjetin më të rëndësishëm të njeriut, në punën dhe zhvillimin më efikas të tij. Ai sot përdoret sikurse nga të rriturit ashtu edhe nga ana e të miturve dhe ofron shumë mundësi për punë, për njohjen e botës së civilizuar me të gjitha anët pozitive që kanë, mirëpo edhe sjellje asociale që tek ne janë të ndaluara. Interneti është paraqitur në vitet e 80-ta dhe 90-ta të shekullit XX, por, fillet e

¹⁵³ Ismail Zejneli, Delikuenca e të miturve, Tetovë/ Prishtinë, 2018, fq. 136.

¹⁵⁴ Ismail Zejneli, Delikuenca e të miturve, Tetovë/ Prishtinë, 2018, fq. 136.

¹⁵⁵ Po aty, fq. 137.

¹⁵⁶ Po aty.

paraqitjes së tij janë në rrjetin global kompjuterik që paraqitet në fund të viteve të 60-ta të shek XX. Teknologjia e internetit është krijuar nga Vinton Cerf në vitin 1973 si pjesë e një projekti të udhëhequr nga Robert Kahn dhe të organizuar nga Advanced Research Projects Agency, pjesë e Departamentit Amerikan të Mbrojtjes. Me këtë zbulim Cerf la shumë mundësi për krijimin, ndërtimin dhe standardizimin e internetit.¹⁵⁷

Sikurse tek televizori po ashtu edhe nëpërmjet internetit shumë të mitur, më shpjet mund të vijnë deri te shikimi i skenave të ndryshme filmike me përmbajtje negative për ta, qofshin ato të zhanreve kriminalistike apo të atyre pornografike. Përmbajtja e këtyre zhanreve të filmave të marrë nëpërmjet internetit mund të ndikojë që disa të mitur të kryejnë vepra penale të vjedhjeve apo të delikuencës seksuale.

Lidhur me ndikimin e kompjuterit në dukurinë e kriminalitetit është shkruar shumë gjatë dekadës së fundit dhe në këtë drejtim janë organizuar debate dhe tubime shkencore dhe profesionale në shumë vende të botës me qëllim që të gjinden metoda dhe mjete për pengimin e keqpërdorimit të kompjuterit për qëllime kompjuterike. Autori gjerman Hans Goppinger thekson se kriminaliteti kompjuterik veçmas del në pah në kryerjen e disa krimeve të cilat ai i ndan në disa veprime. Në rend të parë përmend manipulimet kompjuterike të cilat manifestohen nëpërmes input-output manipulimeve. Veprim tjetër është i ashtuquajturit spiunazh kompjuterik i cili kryhet me anë të programeve të caktuara, duke filluar prej lojrave e deri te programet e lëmive të ndryshme shkencore, ekonomike, financiare dhe strategjike, e të cilat ju sjellin kryerësve apo pirateëve fitime të mëdha financiare. Forma tjetër është e ashtuquajtura sabotazh kompjuterik, që dmth., ndërhyrje ilegale dhe kundërligjore në sisteme dhe programe të ndryshme kompjuterike me qëllim që ato të çrregullohen, të shkatërrohen ose t'u shkaktohen dëme të mëdha material pronarëve të tyre.¹⁵⁸

Ndikimi i literaturës në delikuencën e të miturve. - Edhe literatura sikurse shtypi është faktor i rëndësishëm dhe ka një ndikim pozitiv në ngritjen dhe formimin e gjeneratave të reja. Kur flitet për ndikimin e literaturës në kriminalitet zakonisht mendohet në të ashtuquajturën zbavitëse dhe avantureske e sidomos për romanet kriminalistike. Mirëpo, sot me të drejtë flitet edhe për ndikimin negativ në opinionin e të rinjëve të të ashtuquajtur romane erotike, ato me

¹⁵⁷ E. Beqiri, Interneti, Pejë, 2000, fq. 65.

¹⁵⁸ Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2011, fq. 212.

përmbajtje pornografike të cilat në pjesën më të madhe të rasteve nuk kanë ndonjë vlerë të qëndrueshme artistike dhe nuk kanë ndënjë porosi edukative.¹⁵⁹

Do të duhej që literaturat me përmbajtje negative të ndalohen që t'u shiten të miturve apo që t'u huazohen. Nëpër shkolla do të duhej të inkurajohen që edhe më tepër të lexojnë literaturë alternative me përmbajtje pedagogjike, përpos romaneve të obligueshme shkollore. Literatura dhe mjetet e komunikimit masiv nuk janë direkt përgjegjës për sjelljet delikuede të të miturve, por nëse ekzistojnë edhe faktorë tjerë paradisponues si: jostabiliteti emocional, varfëria apo kushtet e papërshtatshme dhe raportet e çrregullta familjare, atëherë ata i kontribuojnë kësaj dukurie.¹⁶⁰

5. Modelet e suksesshme të parandalimit të kriminalitetit të të miturve

Ekzistojnë programe të ndryshme, të cilat kanë rezultuar të suksesshme për parandalimin dhe trajtimin e sjelljeve delinkuede. Në përgjithësi programe efikase konsiderohen ato që:

- identifikojnë faktorët e riskut dhe ata mbrojtës, ndaj të cilëve janë të ekspozuar të miturit;
- fokusohen më shumë tek të miturit e ekspozuar ndaj faktorëve të riskut;
- ofrojnë ndërhyrje në plane/drejtime të ndryshme;
- janë intesive dhe të vazhdueshme;
- marrin në konsideratë pikat e forta dhe të dobëta të të miturve;
- merren jo vetëm me individin, por dhe me ambientin social që e rrethon.¹⁶¹

Parandalimi i hershëm redukton gjasat që të miturit të përfshihen në sjellje problematike. Programet primare parandaluese përfshijnë të gjithë të miturit dhe jo vetëm ata që shfaqin sjellje kriminale. Përveç këtyre programeve ekzistojnë dhe programe parandaluese dytësore të cilat përfshijnë të miturit që kanë shfaqur tendenca për tu përfshirë në sjellje kriminale. Për të miturit të cilët janë përfshirë në sjellje kriminale ndërtohen programe specifike trajtimi. Qëllimi i trajtimit nëpërmjet këtyre programeve është të mësuarit e strategjive për të rritur nivelin e ndërgjegjegjësimit dhe të autokontrollit në përballje me situatë problematike. Në aplikimin e

¹⁵⁹ Po aty, fq. 266.

¹⁶⁰ A. Dida, Patologjia shoqërore e të miturve në Kosovë, Prishtinë, 1996, fq. 373.

¹⁶¹ Child Delinquency, Bulletin Series, U.S Department of Justice, Office of Justice Programs, Office of Juvenile Justice and Delinquency Prevention, 2003.

programeve është e rëndësishme të punuarit në ekipe multi-disiplinare, për trajtimin në aspekte të ndryshme (psiko-sociale, edukative, arsimore).¹⁶²

Menaxhimi i të miturve me tendenca për tu përfshirë në sjellje delinkuente është një sfidë e vazhdueshme. Sipas literaturës, nëse këto tendenca identifikohen në fëmijëri ose adoleshencë, trajtimi është më efektiv sesa në rastin kur identifikohen tek adultët. Zhvillimi i marrëdhënieve ndërpersonale mund të jetë një nga qëllimet e trajtimit. Vendosja e një marrëdhënieje besimi me individin do të jetë më productive sesa konfrontimi me zemërim, ndëshkimet dhe disiplina e rreptë. Vendosja e kufijve dhe e pritshmërive të qëndrueshme dhe me sens logjik është me rëndësi në mënyrë që të kultivohet përgjegjshmëria individuale për veprimet e kryera. Për një trajtim sa më efektiv rekomandohet bashkëpunimi me familjen, përfshirja në programe arsimimi si dhe caktimi i detyrave specifike të cilat kanë një qëllim të caktuar. Disa nga strategjitë kryerësore të parandalimit janë trajnimi i të miturve, forcimi i marrëdhënieve familjare, përfshirja e të miturve në procesin arsimor, në aktivitete edukative, apo sportive si dhe bashkëpunimi me komunitetin.¹⁶³

Trajnimi i të miturve. - Trajnimi i të miturve përfshin të mësuarin e aftësive të reja të cilat do të lehtësojnë procesin e rritjes, zhvillimin dhe funksionimin e përshtatshëm. Kërkimet e kryera në këtë fushë sugjerojnë se për parandalimin e çrregullimit të sjelljes është e nevojshme të zhvillohen aftësitë e të miturve. Këtu përfshihen aftësitë për të ndërvepruar në mënyrë efektive me të tjerët, kryerjen me sukses të detyrave të caktuara, dhe përdorimin e aftësive për një funksionim sa më të përshtatshëm. Kjo nënkupton të mësuarit e aftësive për zgjidhjen e problemeve, qëndrueshmërisë dhe vetë-kontrollit, dhe zhvillimin e sjelljeve prosociale në vend të atyre antisociale. Aftësitë prosociale zhvillohen nëpërmjet të mësuarit të sjelljeve të përshtatshme zhvillimin e shoqërizimit dhe komunikimit. Zhvillimi social i të miturve i pajis ata me aftësitë e nevojshme për të ndërvepruar pozitivisht me mjedisin.¹⁶⁴

Forcimi i marrëdhënieve familjare. - Marrëdhëniet solide me familjen luajnë një rol të rëndësishëm në parandalimin dhe trajtimin e sjelljeve delinkuente. Çdo i mitur ka nevojë të konsiderohet si pjesë e një sistemi më tepër sesa si një entitet i veçantë. Kërkimet e bëra kanë treguar se prindërit e të miturve më çrregullime të sjelljes kanë pasur një stil prindërimi deficietar.

¹⁶² Ani Beqo, Blerta Doçi, Analizë e faktorëve të riskut që ndikojnë në kriminalitetin e të miturve, Tiranë, Nëntor 2015, fq. 35.

¹⁶³ Ani Beqo, Blerta Doçi, Analizë e faktorëve të riskut që ndikojnë në kriminalitetin e të miturve, Tiranë, Nëntor 2015, fq. 36.

¹⁶⁴ Po aty, fq. 36.

Forcimi i marrëdhënieve mes të miturve dhe familjarëve përmes lehtësimit të vizitave, referimit të shqetësimeve të fëmijës, mbajtjen e kontakteve me prindërit dhe organizimin periodikisht të aktiviteteve me praninë e prindërve të të miturve do të shërbenin për krijimin e një klime gjithnjë e më të sigurtë për të miturit.¹⁶⁵

Arsimimi, programet edukative dhe aktivitetet sportive. - Përfshirja e të miturve në programe arsimore formale dhe joformale luan një rol të rëndësishëm në trajtimin e çrregullimeve të sjelljes. Aktivitetet me karakter edukues duhet të kenë në fokus menaxhimin e zemërimit, zhvillimin e aftësive sociale dhe komunikimit, shpërblimin e sjelljeve të përshtatshme, si dhe inkurajimin e të miturve për të kuptuar ndjenjat e tyre, për të qënë miqësorë, për të komunikuar normalisht, etj. Në këtë kontekst sugjerohet që për këtë kategori të reduktohen sa më shumë të jetë e mundur sjelljet ndëshkuese, dhe në vend të tyre të përdoret përforsimi dhe shpërblimet në mënyrë që të miturit ta ndjejnë veten të vlerësuar për pjesëmarrjen në këto lloj aktivitete. Aktivitetet sportive janë të rëndësishme dhe të dobishme jo vetëm fizikisht, por dhe psikologjikisht, pasi ulin nivelin e stresit dhe rrisin vetëvlerësimin. Këto aktivitete duhet të alternohen, (pra të jenë të llojeve të ndryshme) në mënyrë që të mos bëhen rutinë, si dhe të jenë të organizuara në mënyrë që të miturit të stimulohen dhe ta ndjejnë veten të vlerësuar për pjesëmarrjen.¹⁶⁶

Bashkëpunimi me komunitetin. - Në trajtimin e të miturve me rëndësi do të ishte sigurimi i mbështetjes dhe bashkërendimi i punës me organizma shtetërorë ose privatë që operojnë në fushën e trajtimit të tyre në komunitet. Ky bashkëpunim do të ishte me një rëndësi të madhe sidomos për trajtimin e të miturve në prag-lirimi dhe për vazhdimësinë e trajtimit pas lirimit. Duke marrë parasysh se një pjesë e mirë e të miturve të përfshirë në akte delinkuente kanë pak ose aspak mbështetje nga familjarët ose të afërmit, ndërhyrja e komunitetit do të ishte vendimtare në reduktimin e mundësive për relaks.¹⁶⁷

6. Shërbimi sprovues në Kosovë dhe roli i tij në zbutjen e dukurisë së delinkuencës së të miturve

¹⁶⁵ Po aty, fq. 37.

¹⁶⁶ Ani Beqo, Blerta Doçi, Analizë e faktorëve të riskut që ndikojnë në kriminalitetin e të miturve, Tiranë, Nëntor 2015, fq. 37.

¹⁶⁷ Po aty.

Shërbimi sprovues në Kosovë përbëhet nga Drejtoria e përgjithshme e këtij shërbimi në Prishtinë si dhe 7 zyra rajonale në: Prishtinë, Prizren, Mitrovicë, Pejë, Gjiilan, Ferizaj dhe Gjakovë. SHSK filloi punën me 02. Dhjetor, 2002, si pilot projekt në Prishtinë, nën kompetencat e Divizionit të Menaxhimit Penal/Departamentit të Drejtësisë (shtylla e I-rë e UNMIK-ut). Deri në vitin 2010 funksiononin 5 zyra rajonale të shërbimit sprovues në Kosovë. Zyra e Ferizajt dhe Gjakovës janë hapur pas vitit 2010. Aktualisht Shërbimi Sprovues i Kosovës është organ qendror i administratës shtetërore në vartësi të Ministrisë së Drejtësisë. Misioni i Shërbimit Sprovues është “Ngritja e vetëdijes shoqërore duke bashkëpunuar me të gjitha organet e pushtetit shtetëror për humanizmin e ekzekutimit të dënimeve alternative, reduktimin e krimit, zvogëlimi e shkallës së recidivizmit dhe rritjen e përgjithshme të sigurisë për shoqërinë kosovare”.¹⁶⁸

Misioni i Shërbimit Sprovues të Kosovës është vetë qëllimi i themelimit të këtij institucioni, e që në bazë të ligjeve aplikuese është kalimi i dënimit me burg në dënime alternative më humane psiko-sociale. Shërbimi Sprovues i Kosovës ka të bëjë me: Ekzekutimin, mbikëqyrjen, ri-integrimin, rehabilitimin, risocializimin dhe korrektimin e të gjithë personave që kanë kryer në momente të caktuara vepra penale të ndëshkueshme sipas ligjeve aplikuese në Kosovë.¹⁶⁹ Shërbimi Sprovues i Kosovës bashkëpunon ngushtë me gjykatat, prokuroritë, Burgjet, Qendrat e Paraburgimit dhe institucionet e ndryshme si: qendrat për aftësimin profesional, qendrat për punë sociale, organizata publike, organizatat jo qeveritare, ndërmarrje publike etj.¹⁷⁰

Përveç organeve të tjera, një rol qenësor në zbatimin e legjislacionit për të miturit si kryerës të veprave penale ka Shërbimi Sprovues i Kosovës (SHSK). Shërbimi Sprovues i Kosovës, përkatësisht Shërbimi për Ekzekutimin e Dënimeve Alternative dhe Riintegrimin Shoqëror të personave të dënuar, është përgjegjës për ekzekutimin e dënimeve dhe masave alternative, mbikëqyrjen, risocializimin, reintegrimin dhe rehabilitimin e të gjithë personave që kanë kryer vepra penale të ndëshkueshme sipas ligjeve të aplikueshme në Republikën e Kosovës. Bazën ligjore për punën e Shërbimit Sprovues të Kosovës e përbëjnë këto ligje: Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Kodi i Drejtësisë për të Mitur dhe Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale. SHSK-ja i ofron ndihmë të miturit pas lirim të tij nga Institucioni Korrektues sa ai ka nevojë, por jo më gjatë se një vit. Nëse e sheh të

¹⁶⁸ <http://www.md-ks.net>

¹⁶⁹ Ministria e Drejtësisë, Shërbimi Sprovues i Kosovës. Buletini nr.8. Prishtinë, 2013, fq. 3.

¹⁷⁰ Po aty, fq. 5.

arsyeshme ky institucion kërkon ndihmë nga Organi i Kujdestarisë, ose përfaqësuesi ligjor i të miturit.¹⁷¹

Gjatë qëndrimit të tyre në institucionet edukative-korrektuese hartohen planet individuale, i njohur si program i përkujdesjes pas lirimit, ku marrin pjesë zyrtarët sprovues, puntorët social, puntorët e qendrës korrektuese, prindrit, etj. Me atë rast përpilohet program i reintegrimit gjatë kohës së tij në qendër. Program përfshin aftësimin profesional (murator, elektrikist, ujëinstalues, informatikë, gjuhë të huaja, etj.), si dhe takime të rregullta me grupin që e përcjell realizimin e planit individual. Ky program është i dizajnuar që ta përgadisë që miturin të kthehet në komunitet dhe integrohet sa më lehtë në të. Ideja është të ndikohet në formimin e tij, që ai të jetë i aftë të vazhdoj jetën dhe të mos bjerë në recidivizëm.¹⁷² Përcjellja e të miturit pas lirimit pas lirimit bëhet siç u tha më lartë perms SHSK-së, e mund të kërkohej edhe ndihma e QPS-së.

Rast praktik nga puna:

Përkujdesje pas lirimit

I mituri B.B., është fëmija i nëntë me radhë i familjes së varfër 16 antarëshe, e cila jeton nga asistenca sociale. Që nga mosha 15 vjeç i mituri ka kryer vepra penale të lehta dhe të rënda të vjedhjes. Në moshën 17 vjeç nga Gjykata Komunale i është shqiptuar masa educative - dërgimi në institucionin edukativo-korrektues në kohëzgjatje një vit. Që në fillim të ekzekutimit të masës në Qendrën Korrektuese në Lipjan, duke u bazuar në planin e menaxhimit të rastit dhe Programin e përkujdesjes pas lirimit, zyrtari sprovues është takuar me ekipin multi-disiplinar të përbërë nga menaxheri korrektues, zyrtari korrektues për të mitur-mbikëqyrës blloku për të mitur, zyrtarit për punë sociale-menaxher i rastit, personeli arsimor, zyrtari për pushim dhe argëtim me qëllim të hartimit të planit për riedukimin dhe riintegrimin e të miturit në shoqëri, gjithnjë duke pasur parasysh nevojat e të miturit, qëllimin dhe objektivat të cilat duhen të arrihen sipas këtij plani.¹⁷³

Në kuadër të realizimit të planit për riedukimin dhe ri integrimin e të miturit në shoqëri përveç me stafin e Shërbimit Korrektues, zyrtari sprovues vazhdimisht ka bashkëpunuar edhe me familjen e të miturit, drejtorin e shkollës së mesme, drejtorin e arsimit, stafin e autoskollës, etj.

¹⁷¹ Po aty, fq. 33.

¹⁷² Ministria e Drejtësisë, Shërbimi Sprovues i Kosovës. Buletini nr.8. Prishtinë, 2013, fq. 33.

¹⁷³ Po aty, fq. 35.

Pas daljes nga QKL, zyrtari sprovues ka arritur që të miturit t'ia mundësojë vazhdimin e shkollimit dhe regjistrimin në autoshkollë, në mënyrë që të marrë patent shoferin, meqenëse në planet e tij për të ardhmën dëshiron të punoj si vozitës. Kjo është mundësuar me përkrahjen financiare të UNICEF-it nga fondi për përkrahjen e të miturve. Duke qenë se me të miturin zyrtari sprovues, ka zhvilluar biseda të vazhdueshme gjatë gjithë kohës së mbikëqyrjes lidhur me të, emocionet të cilat ndikojnë në sjelljen e tij, mënyrën sesi mendimet irracionale t'i kthejnë në racionale, si dhe të qartësojnë vizionin e tij për të ardhmën janë vërejtur rezultatet në vijim: tek i mituri vërehet që është më i matur në sjellje, më përgjegjës për veprimet e veta dhe ka fituar një vision dhe shpresë për të ardhmën; i mituri ka kryer një vit të shkollës së mesme me sukses të mirë (mësim intensiv); është aftësuar për një profesion të cilin mund ta shfrytëzojë për të gjetur një vend pune në të ardhmën; gjatë takimeve të shpeshta me familjen e të miturit, e cila ka qenë shumë mirënjohëse për mundësitë e ofruara është arritur që familja ta mbështesë të miturin në rrugën e riedukimit dhe riintegrit të tij në shoqëri

F.I

Zyrtar Sprovues/ Prishtinë

7. Shërbimi korrektues në Kosovë dhe roli i tij në zbutjen e dukurisë së delinkuencës së të miturve

Shërbimi Korrektues i Kosovës është themeluar menjëherë pas luftës, më 05 nëntor 1999, fillimisht me hapjen e Qendrës së Paraburgimit në Prizren. Personeli vendor ishte kryerësisht staf që kishin punuar para luftës. Shërbimi Korrektues i Kosovës, në bashkëpunim me të gjithë partnerët e Drejtësisë dhe në përshtatshmëri të vazhdueshme me ligjet në Kosovë synon të korrektojë dhe risocializojë të burgosurit duke respektuar të drejtat e tyre fundamentale pa marrë parasysh racën, gjuhën dhe religjionin si dhe siguron një ambient të sigurt për stafin, të burgosurit dhe shoqërinë. Fillimisht me ndihmën e donatorëve si dhe më punën e tërë stafit në të gjitha nivelet u krijuan disa kushte më elementare, dhe deri në vitin 2001, viti i cili shënoi fillimin e funksionimit të mirëfilltë, tani Shërbimi vepron dhe ka nën administrim institucionet si: Burgun e Dubravës, Qendrën Korrektuese në Lipjan, Qendrën e Paraburgimit në Prizren, Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë, Qendrën e Paraburgimit në Gjiilan, Qendrën e Paraburgimit në Pejë, Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë, Burgun e Sigurisë së Lartë.¹⁷⁴

¹⁷⁴ Shërbimi Sprovues i Kosovës, Buletini nr. 8, Prishtinë, 2013, fq. 5.

Qendra Korrektuese në Lipjan është ndërtuar në vitin 1978 si institucion korrektues për të mitur si dhe gra e vajza. Në fillim është populluar vetëm me të mitur ndërsa nga viti 1981 ka filluar edhe popullimi me gra e vajza. Si institucion i tillë ka vepruar deri në vitin 1989 për të rifilluar pastaj në vitin 2000. Gjatë periudhës 1998-1999 kjo qendër nuk është menaxhuar dot në mënyrë institucionale. Qendra Korrektuese në Lipjan për të mitur si dhe për gra e vajza është institucion i tipit gjysmë të hapur, i vetmi në Republikën e Kosovës ku janë të vendosur disa kategori të burgosurve si: të miturit me masë edukative, të miturit e dënuar dhe të miturit e paraburgosur si dhe gra dhe vajza të dënuara, të paraburgosura dhe të mitura. Të miturit janë të sistemuar në objekte apo kate të veçanta ndërsa gratë dhe vajzat e mitura në mungesë të hapësirave janë së bashku. Për shkak të mbingarkesave në Qendrat tjera korrektuese në këtë qendër gjenden edhe një kategori të burgosur me dënime të shkurtra ose që janë në përfundim të dënimit(kundërvajtës). Kjo kategori është e ndarë prej të burgosurve të tjerë. Kapaciteti total i Qendrës Korrektuese në Lipjan është 138 vende si dhe 6 vende në lokale të veçanta.¹⁷⁵

KAPITULLI IV

DELIKUENCA E TË MITURVE NË GJYKATËN THEMELORE NË FERIZAJ GJATË PERIUDHËS KOHORE 2014-2019

Numrin e rasteve të delikuencës së të miturve, dinamikën, llojet e masave dhe dënimeve të shqiptuara për delikuentët e mitur në Gjykatën Themelore në Ferizaj për periudhën kohore 2014-2019, do t'i vështrojmë dhe analizojmë përmes paraqitjes në mënyrë tabelare si dhe do të paraqiten edhe disa karakteristika personale dhe sociale të të miturve delikuentë.

1. Numri i rasteve të delikuencës së të miturve në Gjykatën Themelore në Ferizaj për periudhën kohore 2014-2019

Përfshirja e të miturve në kryerjen e veprave penale në regjionin e Ferizajt për periudhën hulumtuese ka qenë e pranishme në numër të madh. Kështu, bazuar në numrin e rasteve të

¹⁷⁵ Shërbimi Sprovues i Kosovës, Buletini nr. 8, Prishtinë, 2013, fq. 6.

delikuencës së të miturve në regjionin e Ferizajt për periudhën hulumtuese kemi ecurinë si vijon:¹⁷⁶

Tabela nr. 1. Numri i rasteve të delikuencës së të miturve në Gjykatën Themelore në Ferizaj për periudhën kohore 2014-2019

Vitet	Numri i përgjithshëm i rasteve të delikuencës së të miturve
2014-2019	1.040

Nga kjo pasqyrë tabelare nr.1 shihet se numri i përgjithshëm i delikuencës së të miturve në Gjykatën Themelore në Ferizaj ka qenë i lartë në periudhën kohore 2014-2019, dhe kjo është mjaft shqetësuese. Numri i përgjithshëm i delikuencës së të miturve gjatë periudhës hulumtuese ka arritur shifrën 1.040 raste.

2. Dinamika e rasteve të delikuencës së të miturve në Gjykatën Themelore në Ferizaj për periudhën kohore 2014-2019

Sipas statistikave të marrura në Gjykatën Themelore në Ferizaj, vlerësohet se në përmasa të mëdha shikuar sipas viteve, për çdo vit mesatarisht në këtë gjykatë janë paraqitur 100 deri 210 raste të delikuencës së të miturve. Kështu, bazuar në dinamikën e delikuencës së të miturve në këtë gjykatë sipas viteve për këtë periudhë kohore kemi ecurinë si vijon:¹⁷⁷

Tabela nr.2. Dinamika e delikuencës së të miturve në Gjykatën Themelore në Ferizaj për periudhën kohore 2014-2019

Numri i delikuencës së të

¹⁷⁶ Statistikat e marrura në Gjykatën Themelore në Ferizaj, për periudhën kohore 2014-2019.

¹⁷⁷ Po aty.

Viti	miturve	Të shprehura në përqindje
2014	107	10.28%
2015	126	12.11%
2016	184	17.69%
2017	210	20.19%
2018	250	24.03%
2019	163	15.67%
Gjithsej:	1.040	100 %

Nga kjo pasqyrë tabelare nr.2 shihet se delikuenca e të miturve në Gjykatën Themelore në Ferizaj gjatë periudhës së hulumtuar kohore ka shënuar rënie dhe ngritje sipas viteve të caktuara, e që është determinuar nga prezenca e faktorëve të shumtë. Kështu, në vitin 2014 numri i delikuentëve të mitur ka qenë i shprehur në 107 raste, në vitin 2015 në 126 raste, në vitin 2016 në 184 raste, në vitin 2017 në 210 raste, në vitin 2018 në 250 raste, në vitin 2019 në 163 raste. Viti 2018 është viti ku më së shumi ka pasur delikuent të mitur.

3. Llojet e masave dhe dënimeve të shqiptuara ndaj të miturve në Gjykatën Themelore në Ferizaj për periudhën kohore 2014-2019

Bazuar në llojet e masave dhe dënimeve të shqiptuara ndaj të miturve në Gjykatën Themelore në Ferizaj për periudhën kohore 2014-2019 kemi ecurinë si vijon:¹⁷⁸

Tabela nr. 3. Llojet e masave dhe dënimeve të shqiptuara ndaj të në Gjykatën Themelore në Ferizaj për periudhën kohore 2014-2019

Llojet e masave dhe dënimeve të shqiptuara	Numri i shqiptimit
Aktgjykim gjykues	3

¹⁷⁸ Po aty.

Masë disiplinore	24
Masë mbikëqyrëse	383
Masë e dërgimit në ente	36
Punë në dobi të përgjithshme	101
Është zgjidhur në mënyrë tjetër	493
Gjithsej:	1.040

Nga të dhënat e paraqitura në tabelën nr.3, që u referohet llojeve të masave dhe dënimeve të shqiptuara ndaj të miturve në Gjykatën Themelore në Ferizaj për periudhën kohore 2014-2019, rezulton se kryerësisht ndaj të miturve janë shqiptuar masat mbikëqyrëse me 383 raste, masa e dërgimit në ente me 36 raste puna në dobi të përgjithshme me 101 raste, masa disiplinore me 24 raste, aktgjykim gjykues në 3 raste dhe të zgjidhura në mënyrë tjetër me 493 raste.

4. Llojet e veprave penale të kryera nga të miturit në regjionin e Ferizajt për periudhën kohore 2014-2019

Bazuar në llojet e veprave penale të kryera nga të miturit në regjionin e Ferizajt për periudhën kohore 2014-2019 kemi ecurinë si vijon:¹⁷⁹

Tabela nr.4. Llojet e veprave penale të kryera nga të miturit në regjionin e Ferizajt për periudhën kohore 2014-2019

Llojet e veprave të kryerja nga të miturit	Numri i veprave të kryera
Vrasje	11
Vrasje e rëndë	3
Lëndim i lehtë trupor	146
Lëndim i rëndë trupor	14

¹⁷⁹ Po aty.

Kanosje	14
Keqtrajtimi seksual i personave nën moshën 16 vjeç	9
Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave prikotrope dhe analoge	22
Kultivim i bimës së hashishit	7
Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge	63
Sulm seksual	2
Vjedhje	167
Vjedhje e rëndë	227
Vjedhje grabiqare	4
Grabitja	30
Shantazhi	3
Vjedhje pylli	109
Mbajtja në pronësi, kontroll dhe posedim të paautorizuar të armëve	17
Rrezikim i trafikut publik	12
Pengim i personit zyrtar	7
Pengimi dhe mosekzekutimi i masave për mbrojtjen e fëmijëve	4
Shpërdorim i pasurisë së huaj	5
Hyrja në sistemet kompjuterike	7
Dhënia e ndihmes kryersve pas kryerjes së veprës penale	1
Nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar ose etnik	1
Sulmi	21
Falsifikim i parasë	14

Nga të dhënat e paraqitura në tabelën nr.4, që u referohet llojeve të veprave penale të kryera nga të miturit në regjionin e Ferizajt për periudhën kohore 2014-2019 shihet se kanë kryer lloje të ndryshme të veprave penale, nga ato më të lehta e deri tek ato më të rënda. Si vepra penale të rënda të kryera nga të miturit në regjionin e Ferizajt për periudhën hulumtuese janë vrasja e rëndë, vjedhja e rëndë, falsifikimi i parasë dhe pengimi i personit zyrtar dhe veprat penale të narkotikëve.

5. Disa karakteristika personale dhe sociale të delikuentëve të mitur në regjionin e Ferizajt për periudhën kohore 2014-2019

Gjatë hulumtimit të bërë kemi marrë edhe disa karakteristika personale dhe sociale të delikuentëve të mitur në regjionin e Ferizajt për periudhën kohore 2014-2019

5.1. Mosha e delikuentëve të mitur në regjionin e Ferizajt për periudhën kohore 2014-2019

Është njëra ndër karakteristikat kryerësore të të miturve. Edhe në regjionin e Ferizajt gjatë periudhës hulumtuese të miturit delikuentë janë nga moshat më të ndryshme. Kështu, bazuar në moshën e të miturve delikuentë në regjionin e Ferizajt për periudhën kohore 2014-2019 kemi ecurinë si vijon:¹⁸⁰

Tabela nr. 5. Mosha e delikuentëve të mitur në regjionin e Ferizajt për periudhën kohore 2014-2019

Mosha	Numri i të dënuarve	Shprehur në përqindje
15 vjeç	310	29.80%
16 vjeç	573	55.09%

¹⁸⁰ Po aty.

17 vjeç	157	15.09%
Gjithsej:	1.040	100%

Nga kjo tabelë shihet se moshat 15 vjeç janë të përfshira në rastet e kryerjes së veprave penale. Mosha 15 vjet ka qenë e pranishme me 310 raste ose 29.80%, mosha 16 vjet ka qenë mosha që ka pasur më së shumti të mitur në kryerjen e veprave penale me 573 raste ose 55.09%, mosha 17 vjet ka qenë e përfshirë me 157 raste ose 15.09%.

5.2. Gjinia e delikuentëve të mitur në regjionin e Ferizajt për periudhën kohore 2014-2019

Gjatë periudhës hulumtuese, në përgjithësi, në pjesën dërmuese të rasteve të delikuentëve të mitur paraqiten meshkujt. Kjo mund të vërehet edhe nga të dhënat statistikore të marra në Gjykatë. Kësisoj, sipas të dhënave të marra për regjionin e Ferizajt, në periudhën kohore 2014-2019, të miturit delikuent sipas gjinisë kishte ecurinë si në vijim:¹⁸¹

Tabela nr. 6. Gjinia e delikuentëve të mitur në regjionin e Ferizajt për periudhën kohore 2014-2019

Viti	Meshkuj	%	Femra	%
2014	107	10.33%	-	-
2015	125	12.07%	1	0.01%
2016	182	17.58%	2	0.47%
2017	210	20.17%	-	-
2018	250	24%	-	-
2019	161	15%	2	0.47%
Gjithsej:	1.035	99%	5	1%

¹⁸¹ Po aty.

Nga kjo pasqyrë tabelare nr. 6 sa i përket gjinisë së të miturve delikuentë gjatë periudhës hulumtuese shihet se meshkujt janë dukshëm më shumë se sa femrat. Respektivisht, gjatë vitit 2014 kanë qenë të mitur 107 meshkuj dhe asnjë femër, gjatë vitit 2015 kanë qenë 125 meshkuj dhe 1 femër, gjatë vitit 2016 kanë qenë 182 meshkuj dhe 2 femra, në vitin 2017 kanë qenë 210 meshkuj dhe asnjë femër, në vitin 2018 kanë qenë 250 meshkuj dhe asnjë femër, dhe në vitin 2019 kanë qenë 161 meshkuj dhe 2 femra. Nga e gjithë kjo shihet se 1.035 të mitur delikuentë kanë qenë meshkuj dhe 5 kanë qenë femra.

5.3 Niveli arsimor i delikuentëve të mitur në regjionin e Ferizajt për periudhën kohore 2014-2019

Kërkimet kriminologjike vërtetojnë se arsimimi konsiderohet faktor i rëndësishëm në luftimin dhe parandalimin e kryerjes së veprave penale. Niveli i ulët arsimor është një ndër faktorët kriminologjen në paraqitjen e veprave të ndryshme penale. Kësisoj, sipas të dhënave të marra në Gjykatën e Ferizajt, në periudhën kohore 2014-2019, personat e mitur delikuentë sipas nivelit arsimor kishin ecurinë si në vijim:¹⁸²

Tabela nr. 7. Niveli arsimor i delikuentëve të mitur në regjionin e Ferizajt për periudhën kohore 2014-2019

Viti	Niveli fillor	Niveli i mesëm
2014	35	72
2015	29	97
2016	53	131
2017	41	169
2018	73	177
2019	79	84

¹⁸² Po aty.

Gjithsej:	310	730
-----------	-----	-----

Nga pasqyra tabelare nr. 7, sa i përket nivelit arsimor të të miturve delikuentë në regjionin e Ferizajt gjatë periudhës hulumtuese, shihet se shumica e të miturve kanë qenë me nivel të mesëm. Gjatë vitit 2014 kanë qenë 35 raste me nivel fillor dhe 72 raste me nivel të mesëm, gjatë vitit 2015 kanë qenë 29 raste me nivel fillor dhe 97 raste me nivel të mesëm arsimor, gjatë vitit 2016 kanë qenë 53 raste me nivel fillor arsimor ndërsa 131 raste me nivel të mesëm, gjatë vitit 2017 kanë qenë 41 raste me nivel fillor dhe 169 raste me nivel të mesëm arsimor, gjatë vitit 2018 kanë qenë 73 raste me nivel fillor ndërsa 177 raste me nivel të mesëm arsimor, gjatë vitit 2019 kanë qenë 79 raste me nivel fillor ndërsa 84 raste me nivel të mesëm arsimor.

Nga e gjithë kjo shihet se 310 të mitur delikuentë gjatë periudhës hulumtuese kanë qenë me nivel fillor arsimor dhe 730 raste me nivel të mesëm arsimor.

5.4. Profesioni i delikuentëve të mitur në regjionin e Ferizajt për periudhën kohore 2014-2019

Sipas të dhënave të marra në Gjykatën e Ferizajt, për periudhën kohore 2014-2019, të miturit delikuentë sipas profesionit kishin ecurinë si në vijim:¹⁸³

Tabela nr.8. Profesioni i delikuentëve të mitur në regjionin e Ferizajt për periudhën kohore 2014-2019

Viti	Nxënës	Pa veprimtari
2014	107	-
2015	126	-
2016	184	-
2017	210	-
2018	250	-
2019	163	-

¹⁸³ Po aty.

Gjithsej:	1.040	-
-----------	--------------	---

Nga pasqyra tabelare nr. 8, sa i përket profesionit të të miturve delikuentë në regjionin e Ferizajt, gjatë periudhës hulumtuese shihet se të gjithë të miturit kanë qenë nxënës.

5.5. Statusi social i delikuentëve të mitur në regjionin e Ferizajt për periudhën kohore 2014-2019

Edhe statusi social konsideroht faktor i rëndësishem në parandalimin e kryerjes së veprave penale. Sipas të dhënave të marra në Gjykatën e Ferizajt, në periudhën kohore 2014-2019, personat e mitur delikuentë, sipas statusit social kishin ecurinë si në vijim:¹⁸⁴

Tabela nr. 9. Statusi social i delikuentëve të mitur në regjionin e Ferizajt për periudhën kohore 2014-2019

Viti	I varfër	I mesëm	I pasur
2014	101	6	-
2015	123	2	1
2016	166	15	3
2017	196	14	-
2018	217	24	9
2019	155	8	-
Gjithsej:	931	69	13

¹⁸⁴ Po aty.

Nga kjo pasqyrë tabelare nr. 9, sa i përket statusit social të të miturve delikuentë në regionin e Ferizajt gjatë periudhës hulumtuese, shihet se shumica e të miturve delikuentë kanë qenë me gjendje të varfër ekonomike. Gjatë vitit 2014 kanë qenë 101 të mitur me gjendje të varfër ekonomike dhe 6 me gjendje të mesme ekonomike, gjatë vitit 2015 kanë qenë 123 të mitur me gjendje të varfër ekonomike, 2 raste me gjendje të mesme ekonomike dhe një rast me gjendje të pasur ekonomike, gjatë vitit 2016 kanë qenë 166 raste me gjendje të varfër ekonomike, 15 raste me gjendje të mesme dhe 3 raste me gjendje të pasur ekonomike, gjatë vitit 2017 kanë qenë 196 raste me gjendje të varfër ekonomike dhe 14 raste me gjendje të mesme, gjatë vitit 2018 kanë qenë 217 raste të të miturve delikuentë me gjendje të varfër, 24 me gjendje të mesme dhe 9 raste me gjendje të pasur ekonomike, gjatë vitit 2019 kanë qenë 155 raste me gjendje të varfër ekonomike, dhe 8 raste me gjendje të mesme ekonomike.

Nga e gjithë kjo shihet se 931 të mitur delikuentë gjatë periudhës hulumtuese kanë qenë me gjendje të varfër ekonomike, 69 raste me gjendje të mesme ekonomike dhe 13 me gjendje të pasur ekonomike.

5.6. Statusi martesor i delikuentëve të mitur në regionin e Ferizajt për periudhën kohore 2014-2019

Sipas të dhënave të marrura në Gjykatën e Ferizajt, në periudhën kohore 2014-2019, personat e mitur delikuentë sipas statusit martesor kishin ecurinë si në vijim:¹⁸⁵

Tabela nr. 10. Statusi martesor i delikuentëve të mitur në regionin e Ferizajt për periudhën kohore 2014-2019

Viti	Martuar	Pa martuar
2014	-	107
2015	-	126
2016	1	183

¹⁸⁵ Po aty.

2017	-	210
2018	3	247
2019	1	162
Gjithsej:	5	1.035

Nga kjo pasqyrë tabelare nr. 10, sa i përket statusit martesor të të miturve delikuentë në regjionin e Ferizajt gjatë periudhës hulumtuese, shihet se shumica e të miturve delikuentë kanë qenë të pamartuar. Gjatë vitit 2014 kanë qenë 107 raste të të miturve delikuentë të pa martuar, gjatë vitit 2015 kanë qenë 126 raste të pa martuar, gjatë vitit 2016 kanë qenë 183 raste të pa martuar dhe një rast i martuar, gjatë vitit 2017 kanë qenë 210 të pamartuar, gjatë vitit 2018 kanë qenë 247 raste të pa martuar dhe 3 raste të martuar dhe gjatë vitit 2019 kanë qenë 162 raste të pa martuar dhe 1 rast i martuar.

Nga e gjithë kjo shihet se 1.035 raste të të miturve delikuentë kanë qenë të pamartuar dhe 5 raste të martuar.

5.7. Përkatësia kombëtare e delikuentëve të mitur në regjionin e Ferizajt për periudhën kohore 2014-2019

Të miturit delikuentë në regjionin e Ferizajt gjatë periudhës hulumtuese kanë qenë personat të nacionalitetit shqiptar dhe të tjerë. Këtë e dëshmojnë edhe evidencat statistikore të mbledhura në Gjykatën e Ferizajt. Bazuar në të dhënat e gjykatës për periudhën 2014-2019, ecuria e të miturve delikuentë sipas përkatësisë kombëtare ishte si vijon:¹⁸⁶

Tabela nr. 11. Përkatësia kombëtare e delikuentëve të mitur në regjionin e Ferizajt për periudhën kohore 2014-2019

Viti	Shqiptar	Të tjerë
2014	105	2

¹⁸⁶ Po aty.

2015	125	1
2016	179	5
2017	207	3
2018	246	4
2019	157	6
Gjithsej:	1.019	21

Nga pasqyra tabelare nr. 11 sa i përket përkatësisë kombëtare të të miturve delikuentë në regjionin e Ferizajt gjatë periudhës hulumtuese, shihet se shumica e të miturve kanë qenë shqiptarë. Gjatë vitit 2014 kanë qenë 105 të mitur delikuentë shqiptarë dhe 2 të tjerë, gjatë vitit 2015 kanë qenë 125 të mitur delikuentë shqiptarë, dhe 1 tjetër, gjatë vitit 2016 kanë qenë 179 të mitur delikuentë shqiptarë dhe 5 të tjerë, gjatë vitit 2017 kanë qenë 207 të mitur delikuent shqiptar dhe 3 të tjerë, gjatë vitit 2018 kanë qenë 246 të mitur delikuentë shqiptarë dhe 4 të tjerë, gjatë vitit 2019 kanë qenë 157 të mitur delikuent shqiptar dhe 6 të tjerë.

Nga e gjithë kjo shihet se 1.019 të mitur delikuentë në regjionin e Ferizajt gjatë periudhës hulumtuese kanë qenë shqipëtar, 21 raste kanë qenë të minoriteteve të tjera.

PËRFUNDIMI

Nga hulumtimet e bëra kam konstatuar se sanksionet penale për të mitur, si mjete kryesore dhe më të shpeshta të reagimit të shoqërisë ndaj kriminalitetit të të miturve, kanë disa karakteristika themelore. Si karakteristika të tilla konsiderohen: me anën e këtyre sanksioneve shoqëria mbron nga kriminaliteti i të miturve vlerat më të rëndësishme të njeriut dhe bashkësisë shoqërore; se ato mund t'u shqiptohen vetëm kryerësve të mitur të veprave penale; se të miturve mund t'u shqiptohet vetëm ai sanksion penal i cili është paraparë me ligj në momentin e kryerjes së veprës penale (nulla pena sine lege); se sanksionet e tilla mund t'i shqiptojë vetëm gjykata; se në rastin e masave të diversitetit edhe prokurori i shtetit, në bazë të procedurës së përcaktuar me ligj, e cila ofron më së shumti garanci për marrjen e vendimit të drejtë dhe të ligjshëm, bën që kryerësve të mitur të veprave penale t'u merren apo kufizohen disa nga liritë dhe të drejtat e tyre; dhe se këto masa janë mjete juridiko-penale të karakterit represiv, të cilat ekzekutohen sipas detyrës zyrtare dhe janë të shumta e të llojllojshme (të karakterit plural) etj.

Literatura e shumtë e përdorur dëshmon se në Kosovë pozita penalo-juridike e të miturve, gjatë periudhave të ndryshme të zhvillimit historik e ka ecurinë dhe specifikat e veta të zhvillimit. Madje, mund të thuhet se rruga e zhvillimit, në drejtim të avancimit të pozitës penalo-juridike të të miturve, ishte jo vetëm rrugë e vështirë, por edhe komplekse.

Në Kosovë, pozita juridike penale e të miturve është rregulluar më Kodin e Drejtësisë për të Mitur. Ky Kod ka paraparë mundësinë që ndaj të miturve të shqiptohen masat e diversitetit, masat edukative dhe dënimet. Masat e diversitetit përbëjnë llojin më të lehtë të sanksioneve penale të cilat mund t'u shqiptohen kryerësve të mitur të veprave penale. Ato kanë si qëllim

kryerësor arritjen e tendencës që delikuenti i mitur të mos i ekspozohet procedurës penale, të mos stigmatizohet dhe të mos i shqiptohen sanksione penale. Ky Kod ka paraparë tetë lloje të masave të diversitetit dhe për shqiptimin e tyre e ka autorizuar prokurorin e shtetit, gjyqtarin për të mitur dhe trupin gjykues për të mitur. Masat edukative përbëjnë llojin kryesor të sanksioneve penale ndaj të miturve që u shqiptohen kësaj kategorie të kryerësve të veprave penale. Ato kanë përparësi në krahasim me çdo sanksion tjetër penal dhe ato përjashtojnë aplikimin e dënimit me burgim për të mitur. Këto masa ndahen në masa disiplinore (qortimi dhe dërgimi në qendrën disiplinore), masa të mbikëqyrjes së shtuar (mbikëqyrja e shtuar nga ana e prindit, prindit adoptues ose kujdestarit, mbikëqyrja e shtuar nga familja tjetër dhe mbikëqyrja e shtuar nga organi i kujdestarisë) dhe masat institucionale (dërgimi në institucionin edukativ, dërgimi në institucionin edukativo-korrektues dhe dërgimi në institucionin e kujdesit të posaçëm). Dënimet (dënimi me gjobë, urdhri për punë në dobi të përgjithshme, burgimi për të mitur dhe dënimet plotësuese) konsiderohen sanksione penale të cilat i shqipton gjykata pas zhvillimit të procedurës së përcaktuar me ligj, ndaj kryerësve të mitur të veprave penale që janë të përgjegjshëm dhe të fajshëm me qëllim të luftimit të kriminalitetit, mbrojtjes së vlerave individuale dhe shoqërore, edukimit, rehabilitimit e zhvillimit të drejtë të të miturit, i cili konsiston në marrjen apo kufizimin e të drejtave të caktuara të kryerësit të mitur të veprës penale.

Edhe pse ligjdhënësi kosovar ka paraparë themelimin e disa institucioneve të posaçme të ekzekutimit të masave edukative, në planin praktik kjo çështje ka ngelur e papërfunduar. Kështu, në Kosovë akoma nuk është ndërtuar ndonjë institucion i posaçëm në të cilin do të ekzekutohej masa e dërgimit në qendrën disiplinore e as ndonjë institucion në të cilin do të ekzekutohej masa e dërgimit në institucionin edukativ. Në mungesë të këtyre institucioneve, ekzekutimi i këtyre masave vazhdon të bëhet në kuadër të konvikteve të nxënësve, shkollave e qendrave ekzistuese për të rinjtë, ku procedurat e trajtimit të të miturve delikuentë hasin në probleme nga më të ndryshmet. Këto probleme, përveç mungesës së kushteve të përshtatshme për ta, përcillen edhe me mungesë të kuadrit të specializuar që do të merrej me riedukimin e të miturve delikuentë, përfshirë edhe mosgatishmërinë e udhëheqësve të institucioneve të sipërcekura për të pranuar brenda tyre të mitur që kanë kryer vepra penale.

Edhe pse disa nga faktorët e riskut janë të njëjtë për një pjesë të mirë të të miturve në konflikt me ligjin, tiparet dhe kombinimi i këtyre faktorëve variojnë rast pas rasti. Pjesa më e madhe e profesionistëve janë të mendimit se në fëmijërinë e hershme risku më i lartë vjen nga

faktorët individualë (si p.sh. komplikacionet në lindje, hiperaktiviteti, temperament i vështirë etj.) dhe faktorë familjarë (p.sh. sjellja prindërore antisociale apo kriminale, abuzimi me substancat, neglizhenca etj.), ndërsa fëmija rritet dhe integrohet në shoqëri fillojnë të luajnë një rol shumë të rëndësishëm faktorët e rinj të riskut që lidhen me influencën e bashkëmoshatarëve, shkollën dhe komunitetin.

Sipas Ligjit mbi Drejtësinë për të Mitur për një prevencion më të suksesshëm të delikuencës së të miturve, themelohen këshisha shtetërore dhe këshilla komunale për preventivë. Këshilli shtetëror është i pavarur dhe i mëvetësishëm në punën e përcaktuar me këtë ligj. Sipas dispozitave pozitive në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ndaj delikuentëve të mitur të cilët kanë kryer vepra penale mund të shqiptohen disa lloje të masave parandaluese dhe edukative përmirësuese.

Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur përmban rregullime të posaçme lidhur me përgjegjësinë penale të të miturve, rregulla procedurale lidhur me hetimin, ndjekjen penale, procesin gjyqësor, ekzekutimin e vendimit të dënimit penal, rehabilitimin ose çdo masë tjetër që përfshinë një të mitur në konflikt me ligjin, si dhe një të mitur viktimë dhe/ose dëshmitar të veprës penale. Parimet e këtij Kodi kanë efekt në të gjithë përmbajtjen e tij dhe zbatohen nga çdo person dhe organ kompetent në të gjitha veprimet dhe vendimet e tyre lidhur me të miturin në konflikt me ligjin, të miturin viktimë ose/dhe dëshmitar i veprës penale. Parimet e këtij Kodi zbatohen edhe në veprimet administrative të policisë dhe të organeve të tjera që kryejnë veprimtari administrative në kuadrin e drejtësisë penale për të mitur.

Nga paraqitja dhe analiza e delikuencës së të miturve në regjionin e Ferizajt për periudhën kohore 2014-2019 kemi konstatuar se delikuenca e të miturve është me numër të lartë e pranishme në këtë regjion dhe se për çdo vit mesatarisht delikuenca e të miturve është prezente 100 deri 210 raste.

Llojet e masave dhe dënimeve të shqiptuara për delikuentët e mitur në regjionin e Ferizajt për periudhën 2014-2019 kanë qenë masat disiplinore, mbikëqyrëse, masat e dërgimit në ente dhe puna në dobi të përgjithshme.

Shikuar sipas llojeve të veprave penale të kryera nga të miturit në regjionin e Ferizajt për periudhën kohore 2014-2019, shihet se kanë kryer lloje të ndryshme të veprave penale, nga ato më të lehta e deri tek ato më të rënda. Si vepra penale të rënda të kryera nga të miturit në

regionin e Ferizajt për periudhën hulumtuese, janë vrasja e rëndë, vjedhja e rëndë, falsifikimi i parasë, pengimi i personit zyrtar dhe veprat penale të narkotikëve.

Gjithashtu, gjatë hulumtimit kemi analizuar edhe disa karakteristika personale dhe sociale të të miturve delikuentë në regionin e Ferizajt për periudhën hulumtuese. Kështu, të miturit delikuent janë nga moshat nga 15-17 vjeç. Si subjekte të të miturve delikuentë gjatë periudhës hulumtuese në pjesën dërmuese të rasteve paraqiten meshkujt. Nga të dhënat që kanë bëjnë me nivelin arsimor të të miturve delikuentë gjatë periudhës hulumtuese prinë niveli i mesëm arsimor. Duke vështruar profesionin e të miturve, kryesisht janë paraqitur rastet nxënës. Statusi social i të miturve delikuentë paraqitet mjaft i ulët, ku shumica e të miturve kanë qenë me status të varfër ekonomik. Statusi martesor i të miturve prinë me personat e pamartuar, si të mitur gjatë periudhës hulumtuese. Në kryerjen e veprave penale si të mitur delikuentë gjatë periudhës hulumtuese kanë marrë pjesë persona të nacionalitetit shqiptar e të tjerë.

LITERATURA

I. Libra dhe artikuj shkencorë

1. Beqo, Ani, Blerta Doçi, Analizë e faktorëve të riskut që ndikojnë në kriminalitetin e të miturve, Tiranë, Nëntor 2015.
2. Beqiri, E., Interneti, Pejë, 2000.
3. Dida, A. Patologjia shoqërore e të miturve në Kosovë, Prishtinë, 1996.
4. Conseur, A., Rivara, F.O., Barnowsky, R., and Emmanuel, I., “Maternal and perinatal risk factors for later delinquency”, 1997.
5. Costello, E.J., Farmer, E.M., Angold, A. Burns, B., and Erkanli, A., “Psychiatric disorders among American Indian and White youth in Appalachia: The great Smoky Mountains Study”. American Journal of Public Health, 1997.
6. Child Delinquency, Bulletin Series, U.S Department of Justice, Office of Justice Programs, Office of Juvenile Justice and Delinquency Prevention, 2003.
7. Farrington, D.P., “Predictors, causes and correlates of male youth violence”, In youth violence, vol.24, edited by M. Tonry and M.H. Moore. Chicago I.L: University of Chicago Press, 1998.
8. Fergusson, D.M., and Horwood, L.J., “Early disruptive behavior IQ, and later school achievement and delinquent behavior” Journal of Abnormal Child Psychology, 1995.

9. Farrington, D.P., Barnes, G.C., and Lambert, S., "The concentration of offending in families". *Legal and Criminological Psychology*, 1996.
10. Gashi Rexhep, "Politika ndëshkimore ndja delikteve të gjakut në Kosovë gjatë periudhës 1980-1989", Prishtinë, 2003
11. Gashi Rexhep, Kodi i Drejtësisë për të Mitur i Kosovës (rëndësia, risitë dhe ndryshimet më të rëndësishme), E drejta, nr. 3, Prishtinë, 1996.
12. Halili, Ragip, *Kriminologjia*, Prishtinë, 2007.
13. Halili Ragip, "Kriminologjia", Prishtinë, 2011.
14. Halili, Ragip, *Penologjia*, Prishtinë, 2010.
15. Halili, Ragip *Kriminologjia*, Prishtinë, 2016.
16. Hajdari Azem, *Kriminaliteti i të miturve 2001-2003*, Prishtinë, 2004.
17. Hysi Vasilika, *Kriminologjia*, Tiranë, 2010.
18. Hawkins, J.D., Herrenkohl, T., Farrington, D.P., Brecher, D., Catalano, R.F., and Harachi, T.W. "Gardner, F.E.M., "Positive interaction between mothers and conduct-problem children: Is there training for harmony as well as fighting?", *Journal of Abnormal Child Psychology*, 1987.
19. Hughes H.M., Parkinson, D., and Vargo, M., "Witnessing spouse abuse and experiencing physical abuse", *Journal of Family Violence*, 1989.
20. Kanuni i Lek Dugagjinit, permbledhur dhe kodifikuar nga Shtejfen Gjecovi me biografi dhe parathenie të Syrja Pupovcit, 1972.
21. Kibben, L., De Vos, E., and New Berger, E., "Victimization of mothers of abused children: A controlled study", 1989.
22. Kambovski, Vllado, *Edrejta penale e përgjithshme*, Shkup 2010.
23. Kambovski, Vllado, Zejneli, Ismil, *E drejta penale-pjesa e përgjithshme*, Tetovë, 2018.
24. Latifi Vesel, "Kriminalistika", Prishtinë, 2011.
25. Latifi Vesel, *Kriminalistikat e delikuencës së të miturve*, Prishtinë, 1982.
26. Latifi, Vesel, Halili, Ragip, *Kriminaliteti i të rinjëve në Kosovë*, Prishtinë, 1997.
27. Loeber, R., Green, S.M., Keenan, K., and Lahey, B.B., "Which boys will fare worse? Early predictors of the onset of conduct disorder in a six year longitudinal study" *Journal of American Academy of Child and Adolescent Psychiatry*, 1995.

28. Lahey, B.B., Piacentini, J.C., Mc Burnett, K., Stone, P., Hartdagen, S., and Hynd, G., “Psychopathology in the parents of children with conduct disorder and hyperactivity”, Journal of the American Academy of Child and Adolescent Psychiatry, 1988.
29. Lanahan, S., and Booth, K., “Mother-only families: Problems, prospects and politics”, Journal of Marriage and Family, 1989.
30. Muçi, Sh. E drejta penale Pjesa e përgjithshme, Tiranë, 2007.
31. Moffit, T.E., “The neuropsychology of conduct disorder” Development and psychopathology, 1993.
32. Ministria e Drejtësisë, Shërbimi Sprovues i Kosovës. Buletini nr.8. Prishtinë, 2013.
33. Peza, N. & Elezi I. & Gjika, Gr etj. E drejta penale e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë (Pjesa e përgjithshme), Tiranë, 1982.
34. Patterson, G.R., Crosby, L., and Vulchinich, S. “Predicting risk for early police arrest. Journal of Quantitative Criminology”, 1992.
35. Pearson, J.L., Jalongo, H.S., Hunter, A.G., and Kellum, S.G., “Family Structure and Aggressive behavior in a population of urban elementary school children”, Journal of the American Academy of Child and Adolescent Psychiatry, 1994.
36. Reid, W.J., and Crisafulli, A., “Marital discord and child behavior problems: A meta analysis”, Journal of Abnormal Child Psychology, 1990.
37. Rutter, M., Giller, H., and Hagell, A., “Antisocial Behavior by Young People”, New York, Cambridge University Press, 1998.
38. Salihu Ismet, E drejta penale, pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2015.
39. Salihu Ismet, E drejta penale për të mitur, Prishtinë, 2005.
40. Sulejmanov, Zoran, Penologjia, Shkup, 2000.
41. Sulejmanov, Z., Makedonska Kriminologjia, Shkup, 2000.
42. Shërbimi Sprovues i Kosovës, buletini nr. 8, Prishtinë, 2013.
43. Turkeshi Enkelejda, Masat edukative të parashikuara në Kodin Penal dhe zbatimi i tyre në Shqipëri, Revista Shqiptare për Studime Ligjore, Vol. 4, nr. 1, Tiranë, 2011. I qasshëm në: http://www.ajls.org/doc/4_ETurkeshi_Takimi_V.pdf.
44. Udhëzues mbi zbatimin e masave të diversitetit për të miturit nga Shërbimi Sprovues i Kosovës, Prishtinë, 2019.

45. Zuckerman, B., Augustyn, M., Groves, B.M., and Parker, S., "Silent victim revisited: the special case of domestic violence", 1995.
46. Zejneli, Ismil, Delikuenca e të miturve, Tetovë, Prishtinë, 2018.
47. White, J.L., Moffitt, T.E., Earls, F., Robins, L., and Silva P.A., "How early can we tell? Predictors of childhood conduct disorder and delinquency. Criminology, 1990.
48. Widom, C.S., "The cycle of violence Science", 1989.
49. West, D.J., and Farrington, D.P, "Who became delinquent?", London, England, 1973.

II. Konventa, Ligje dhe akte tjera

1. Konventa për të drejtat e fëmijës, 1989.
2. Kodi Nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur.
3. Ligji Nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.
4. Kodi nr. 04/L-082, Kodi Penal i Republikës së Kosovës.
5. Ligjit mbi Drejtësinë për të Mitur i Republikës së Maqedonisë të Veriut, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 87/2008.
6. Ligji Nr. 37/2017, i Drejtësisë Penale për të Mitur i R. së Shqipërisë.
7. Rregullat e Pekinit, 1985.

III. Praktika gjyqësore e Gjykatës Themelore në Ferizaj për periudhën kohore 2014-2019

1. Statistikat e marra në Gjykatën Themelore në Ferizaj, për periudhën kohore 2014-2019.

